



Raporti Paraprak i Përmbledhur 2019

*Performanca e Kontratave të
Koncesioneve/Partneritetit Publik Privat*

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ky raport është dokument i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që përfshin mbledhjen dhe raportimin e ecurisë dhe performancës financiare dhe jofinanciare të Kontratave të Koncesionit/PPP në Republikën e Shqipërisë të publikuara në Regjistrin e Koncesionit/ Partneritetit Publik Privat.

Nëntor, 2019

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr.3, Tiranë, 1000, Shqipëri

Tabela e Përmbajtjes

Lista e Shkurtimeve	4
Shpjegim i termave	5
Përmbledhje	7
1. Hyrje	9
1.1. Koncepti i Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat	9
1.2. Kuadri Ligjor i Koncesioneve/PPP në R.Sh	12
1.3. Ecuria e projekteve Koncesion/PPP në Shqipëri	13
2. Prezantim i ecurisë së 10 Kontratave Koncesionare/PPP në Shqipëri	19
2.1. Kontrata Koncesionare “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot-Morinë”	20
2.2. Kontrata Koncesionare “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit”	23
2.3. Kontrata Koncesionare “Ndërtimi, vënia në punë, operimi dhe mirëmbajtja e aeroportit ‘Nënë Tereza’”	26
2.4. Kontrata Koncesionare “Për Ndërtimin e Landfillit, Inceneratorit dhe rehabilitimin e Venddepozitimeve ekzistuese, Tiranë”	29
2.5. Kontrata Koncesionare “Për ndërtimin e administrimit e impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier dhe prodhimin e Energjisë”	32
2.6. Kontrata Koncesionare “Për shërbime të integruara për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikal, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, si dhe trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”	34
2.7. Kontrata Koncesionare “Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë për grupmoshat 35-70”	37
2.8. Kontrata Koncesionare “Për projektimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Hidrocentralit Ashta”	39
2.9. Kontrata koncesionare “Për projektimin financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumën Devoll”	41
2.10. Kontrata Koncesionare “Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të konteinereve e automjeteve të tjera në RSH	43
3. Lista e Koncesioneve/PPP të miratuara	46

Lista e Figurave

Figura 1: Trendi i projekteve me Koncesioneve/PPP të miratuara ndër vite, 2004-2019	13
Figura 2: Pesha e projekteve me koncesion/PPP në PBB, 2004-2019	14
Figura 3: Projekte Koncesion/PPP të kërkuara dhe të pakërkuara (Nr.), 2004-2019	15
Figura 4: Numri total i kontratave koncesionare/PPP të miratuara për periudhat 2004-2013 dhe 2014-2019.....	15
Figura 5: Numri i kontratave Koncesionare/PPP sipas Autoritetit Kontraktues, 2019	16
Figura 6: Numri dhe vlera totale e investimit (në lekë) të projekteve Koncesionare/PPP aktive sipas sektorëve, 2019	16
Figura 7: Projekte Koncesion/PPP me dhe pa mbështetje buxhetore (në total nr.).....	17
Figura 8: Pagesat buxhetore për kontratat me mbështetje buxhetore	18
Figura 9: Përpjesa e pagesave buxhetore ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor	19
Figura 10: Alokimi i risqeve në kontratën e koncesionit/PPP “Milot-Morinë”	22
Figura 11: Alokimi i risqeve në kontratën e koncesionit/PPP “Rruga e Arbrit”	25
Figura 12: Alokimi i risqeve në kontratën e koncesionit/PPP “Aeroporti Nënë Tereza”.....	28
Figura 13: Alokimi i risqeve në kontratën e koncesionit/PPP “Inceneratori i Tiranës”	31
Figura 14: Alokimi i risqeve në kontratën e koncesionit/PPP “Inceneratori i Fierit”	33
Figura 15: Alokimi i risqeve në kontratën e koncesionit/PPP “Setet Kirurgjikale”	36
Figura 16: Alokimi i risqeve në kontratën e koncesionit/PPP “Kontrolli Mjekësor Bazë Check-Up”	38
Figura 17: Alokimi i risqeve në kontratën e koncesionit/PPP “Hidrocentrali Ashta”	40
Figura 18: Alokimi i risqeve në kontratën e koncesionit/PPP “Kaskada e Devollit”	42
Figura 19: Alokimi i risqeve në kontratën e koncesionit/PPP “Skanimi i Doganave”	45

Lista e tabelave

Tabela 1: Pagesat buxhetore për projektin “Milot-Morinë”	21
Tabela 2: Të ardhurat nga tarifata e përdoruesve të rrugës “Milot-Morinë”	21
Tabela 3: Vlera e investuar ndër vite	21
Tabela 4: Pagesat buxhetore për projektin “Rruga e Arbrit”	24
Tabela 5: Vlera e investimit “Rruga e Arbrit”	24
Tabela 6: Numri i pasagjerëve ndër vite	27
Tabela 7: Pagesat e tarifës për ton mbetje për projektin “Inceneratori i Tiranës”	30
Tabela 8: Vlera e investimit për projektin “Inceneratori i Tiranës”	30
Tabela 9: Niveli i kërkesës	31
Tabela 10: Pagesat Buxhetore për projektin “Inceneratori i Fierit”	33
Tabela 11: Pësia specifike e llojit të ndërhyrjeve të përdorura	35
Tabela 12: Pagesat Buxhetore për projektin “Setet Kirurgjikale”	35
Tabela 13: Numri i Përfituesve të kontrollit mjekësor bazë Check-Up	38
Tabela 14: Pagesat Buxhetore për projektin “Kontrolli Mjekësor Bazë Check-Up ”	38
Tabela 15: Sasia e energjisë së prodhuar (në GWh/Vit)	40
Tabela 16: Sasia e energjisë së prodhuar (në GWh/Vit)	42
Tabela 17: Pagesat buxhetore për projektin “Skanimi i Doganave”	44
Tabela 18: Numri i skanimeve ndër vite	45
Tabela 19: Lista e kontratave koncesionare/PPP	46

Lista e Shkurtimeve

ANTA	Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror
ATRAKO	Agjencia e Trajtimt të Koncesioneve
BB	Banka Botërore
BOT	Ndërtim-Operim- Transferim (Build Operate Transfer)
BOOT	Ndërtim-Zotërim-Operim-Transferim
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
KE	Komisioni Europian
KESH	Korporata e Energjisë Shqiptare
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PPP	Partneriteti Publik Privat
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
ROT	Rehabilitim- Operim- Transferim
RVP	Raporti Vjetor i Përmbledhur
SMS	Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë
SPV	Subjekti për Qëllime të Veçanta

Shpjegim i termave

1. **Raporti Vjetor i Përmbledhur (RVP)** është një dokument i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që përfshin mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të ecurisë dhe performancës financiare dhe jofinanciare të kontratave të koncesionit/PPP i cili synon të sigurojë që risqet kryesore fiskale nga kontratat e koncesionit/PPP janë identifikuar dhe raportuar në mënyrë sistematike.
2. **"Koncesioni i punëve/shërbimeve publike"** është një marrëveshje me interes financiar, e lidhur me shkrim ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, objekti i së cilës është kryerja e punimeve, ku shpërblimi për punimet/shërbimet që duhet të kryhen përbëhet nga e drejta për të shfrytëzuar veprat/ shërbimet që janë objekt i kontratës ose nga kjo e drejtë së bashku me pagesën.
3. **"Koncesionari"** është operatori ekonomik ose subjekti për qëllime të veçanta, me të cilin autoriteti kontraktues ka nënshkruar një kontratë koncesioni.
4. **"Subjekti për qëllime të veçanta (SPV)"** është:
 - a) një person juridik privat, me seli në Republikën e Shqipërisë, i krijuar me kërkesë të autoritetit kontraktues nga operatori ekonomik i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm, me të cilin lidhet kontrata.
 - b) një formë e partneritetit publik privat që konsiston në krijimin e një entiteti të përbashkët të partnerit publik dhe atij privat, që kryen punë apo shërbime në bazë të një kontrate koncesioni /PPP dhe ku kontributi i partnerit privat konsiston përveç kontributit në kapital apo asete, edhe në pjesëmarrje aktive në menaxhimin e kontratës së koncesionit /PPP. Injektimet e thjeshta të kapitalit nga investitorët privatë në kompanitë shtetërore nuk përbëjnë SPV.
5. **"Propozim i pakërkuar"** është propozimi për të marrë përsipër projekte koncesioni, i cili nuk ka ardhur në përgjigje të një kërkesë të bërë nga autoriteti kontraktues, në kuadër të një procedure përzgjedhëse konkurruese.
6. **"Mbështetja financiare"** është lloji i mbështetjes monetare ose jomonetare dhe/ose financimi i dhënë nga sektori publik, duke përfshirë, por pa u kufizuar, subvencione, garanci financiare apo të tjera, kontribute kapitale dhe transferim të të drejtave të pronësisë.
7. **"Vlera e parasë"** është një term, i cili përdoret për të përcaktuar nëse autoriteti kontraktues ka marrë fitimet maksimale të mundshme nga punët apo shërbimet e dhëna me koncesion/partneritet publik privat. Ky term nuk kufizohet në masën e vlerës së parasë së punëve/shërbimeve, por përfshin, gjithashtu, edhe vlerësimin e cilësisë, kostos dhe shfrytëzimin e burimeve, përshtatshmërinë me qëllimin dhe objektivin e kontratës, kohën dhe mundësinë për të vendosur nëse të gjitha këto elemente të kombinuara përbëjnë vlerën me të mirë ekonomike.
8. **"Kontraktues"** është çdo person, fizik ose juridik, ent publik ose grup personash dhe/ose organesh të tilla që ofrojnë në treg, respektivisht, realizimin e punëve dhe/ose të punëve dhe shërbimeve.
9. **"Kontratë koncesioni"** është një kontratë e nënshkruar ndërmjet autoritetit kontraktues në një rën anë dhe operatorit ekonomik të zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm apo subjektit, për qëllime të veçanta (SPV), i themeluar nga operatori ekonomik në fjalë, kontratë e cila përmban përcaktimet që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet në lidhje me koncesionin e dhënë.

10. **“Kontratë e partneritetit publik privat”** ka kuptimin e një kontrate pune publike apo kontrate të shërbimit publik, që plotëson kushtet, të cilat e përcaktojnë atë si një partneritet publik privat, sikurse është rregulluar në këtë ligj dhe që nënshkruhet ndërmjet autoritetit kontraktues në njërin anë dhe operatorit ekonomik të zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm
11. **“Datë Efektive e Kontratës”** është data në të cilën kontrata fillon zbatimin e saj dhe prodhon efekte juridike.

Përmbledhje

Ky është një Raport Paraprak i Përmbledhur¹ hartuar për herë të parë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet Drejtorisë së Koncesioneve, i cili synon të japë një pamje të përgjithshme të ecurisë financiare dhe jo financiare ndër vite të 10 kontratave koncesionare/PPP me vlerën më të madhe monetare sipas sektorëve specifikë si: transporti, shëndetësia, energjitika, mjedisi dhe kontrolli fiskal. Ky raport përfshin periudhën kohore Janar-Shtator 2019, periudhë gjatë të cilës është mbledhur informacioni mbi treguesit e performancës së këtyre kontratave dhe risqet që implikojnë.

Ky raport i paraprin Raportit Vjetor të Përmbledhur, i cili ka si qëllim të sigurojë një informacion të përmbledhur në lidhje me ecurinë dhe performancën e kontratave të Koncesioneve/PPP-ve në Republikën e Shqipërisë, në kuadër të përmirësimit të transparencës me publikun dhe do të publikohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 125/2013 “Për koncesionet/PPP” i ndryshuar. Gjithashtu, ky raport synon të sigurojë që risqet kryesore fiskale nga kontratat e koncesionit/PPP janë identifikuar dhe raportuar në mënyrë sistematike.

Me qëllim rritjen e transparencës mbi funksionimin e koncesioneve/PPP, forcimin e disiplinës financiare, monitorimin e risqeve fiskale dhe buxhetore që burojnë nga kontratat e koncesionit/PPP, është miratuar Ligji Nr.50 datë 18.07.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” i ndryshuar, i cili përforcon rolin e MFE-së në monitorimin e zbatueshmërisë së projekteve të dhëna me Koncesion/PPP në këndvështrimin e implikimeve financiare.

Në bazë të pikës 7 të nenit 10 të Ligjit Nr. 125/2013 “Për koncesionet/PPP” i ndryshuar, RVP do të përgatitet dhe publikohet një herë në vit dhe do të jetë pjesë si aneks i raportit vjetor të zbatimit të buxhetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor. RVP-ja do të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- Një pamje e përgjithshme të portofolit aktual të Koncesioneve/PPP-ve (vlera totale e projekteve me koncesion/PPP, numrin e kontratave, statusin e projekteve dhe burimin e financimit). Gjithashtu, nëpërmjet RVP-së do të sigurohet edhe një rishikim i ndryshimeve në portofolin e PPP-ve (numrin e projekteve me ndryshime të statusit të projektit, vlerat e përditësuara të kontratave nëse ka).
- Një përshkrim të performancës së portofolit të Koncesioneve/PPP (statistika mbi treguesit financiarë dhe jofinanciarë të projektit si statistika mbi ndërtimin, statistikat specifike të performancës së sektorit etj). Gjithashtu në këtë seksion do të paraqitet një përmbledhje e pagesave buxhetore të parashikuara dhe atyre të realizuara sipas PBA-së, si dhe risqet që rrjedhin nga këto kontrata koncesioni/PPP, nëse janë materializuar apo jo, impaktin në buxhetin e shtetit dhe probabilitetin që kanë për të ndodhur.

¹ Ministria e Financave dhe Ekonomisë është asistuar nga Ekspertët e Bankës Botërore financiar nga Delegacioni i Bashkimit Europian dhe Federata e Zvicrës.

Njësitë përgjegjëse të cilët janë aktorët kryesorë në monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të kontratave të koncesionit/PPP-ve janë: Autoritetet Kontraktuese dhe njësitë brenda MFE, përgjegjëse për përgatitjen e raportit të përmbledhur vjetor mbi ecurinë e zbatimit të kontratave aktive të koncesionit/PPP si dhe ATRAKO.

Në Republikën e Shqipërisë janë lidhur një sërë kontratash koncesioni në sektorë të rëndësishëm duke e përdorur si një metodë alternative në ofrimin e veprave, punëve dhe shërbimeve. Synimi i dhënies së punëve apo shërbimeve publike me koncesion/PPP ka qenë sigurimi i një sërë avantazhesh në lidhje me përmirësimin e cilësisë së ofrimit të tyre mbi: standardin, kohën më të shkurtër, vlerën më të mirë për para dhe inovacionin e shtuar në shumë sektorë. Megjithatë për ofrimin e punëve dhe shërbimeve publike me efikasitet duhet të sigurohet një kuadër i mirëorganizuar institucional, ligjor dhe rregullativ në mënyrë që të maksimizohen avantazhet e kësaj metode investimi, të forcohet monitorimi i ecurisë së tyre, si dhe të reduktohen risqet e ndërmarra nga aktorët e përfshirë në to.

Procesi i monitorimit të kontratave të koncesioneve/PPP dhe raportimit nga Autoritetet Kontraktuese ka filluar për herë të parë në muajin Mars të vitit 2019 në zbatim të paragrafit të dytë të pikës 121, seksioni IV të Udhëzimit plotësues nr. 1 datë 17.01.2019 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2019”.

Duke qenë ky raport përgatitet për herë të parë, është parashikuar që publikimi i tij të bëhet në muajin Nëntor 2019. Nisur nga kompleksiteti i kontratave të koncesionit/PPP, si dhe forcimit të kuadrit ligjor të monitorimit të të gjitha kontratave të koncesionit/PPP, në vijim ky raport mund të pësojë ndryshime me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së tij.

Në bazë të raportimeve të bëra deri tani nga Autoritetet Kontraktuese në këtë raport janë përzgjedhur për t’u prezantuar 10 projekte të rëndësishme me vlera të konsiderueshme, për të cilat të dhënat e përcjella nga Autoritetet Kontraktuese kanë qenë më të sakta. Nga këto, 7 projekte janë me mbështetje buxhetore, dy kontrata koncesioni në fushën e energjisë (hidrocentrale) dhe njëra është kontrata e koncesionit të aeroportit “Nënë Tereza”.

1. Hyrje

Ky raport synon të prezantojë në mënyrë të përmbledhur një informacion mbi ecurinë dhe zbatueshmërinë e kontratave të koncesionit /PPP në Republikën e Shqipërisë të raportuara nga Autoritetet Kontraktuese pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë lidhur me risqet fiskale dhe implikimet buxhetore. Këto raportime janë bërë sipas përmbajtjes së dy shtojcave, formatet e të cilave janë përgatitur bazuar në praktikat ndërkombëtare të asistuar nga Ekspertët e Bankës Botërore, të financuar nga Delegacioni i Bashkimit Europian dhe Federata e Zvicrës. Këta ekspertë kanë asistuar inicimin e procesit të monitorimit të kontratave të koncesionit/PPP nga MFE në këndvështrimin e implikimeve buxhetore.

Nisur nga numri i lartë i kontratave të koncesionit/PPP të lidhura në Republikën e Shqipërisë dhe kompleksitetit të tyre, është e rëndësishme të sqarohet se numri i kontratave të paraqitura në këtë raport është i kufizuar në 10. Me konsolidimin e procesit të monitorimit dhe hyrjen në fuqi të Udhëzimit në zbatim të nenit 10 të Ligjit Nr. 125/2013 i ndryshuar, i cili do të përcaktojë rregullat standarde, procedurat, afatet që duhet të ndiqen në procesin e raportimit dhe monitorimit të ecurisë dhe performancës financiare dhe jo financiare të kontratave të koncesionit/PPP nga të gjitha Autoritetet Kontraktuese, synohet që në vijim të pasqyrohen në RVP-në pasardhëse të gjitha kontratat e koncesionit/PPP që do të raportohen nga Autoritetet Kontraktuese pranë MFE-së.

Objekt i RVP-së janë të gjitha kontratat e koncesionit/PPP të lidhura në bazë të Ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, Ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006, “Për Koncesionet”, Ligji nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, si dhe të gjitha kontratat e tjera të publikuara në Regjistrin e Koncesioneve në faqen zyrtare të ATRAKO-s. Në total në Shqipëri deri në vitin 2019 rezultojnë 222 kontrata koncesionare, nga të cilat 207 janë pa mbështetje buxhetore dhe 14 me mbështetje buxhetore.

1.1. Koncepti i Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat

Para se të jepet një përshkrim i përgjithshëm i situatës së koncesioneve dhe PPP-ve në R.Sh. është e nevojshme të jepet një përkufizim i PPP-ve dhe koncesioneve. Koncesioni është një formë partneriteti midis palës publike dhe asaj private në ofrimin e punëve dhe shërbimeve publike.

Sipas Ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet/PPP në R.Sh” i ndryshuar, përkufizimi i koncesioneve jepet në këtë mënyrë:

“Koncesioni është një marrëveshje me interes financiar, e lidhur me shkrim ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, objekti i së cilës është kryerja e punimeve, ku shpërblimi për punimet/shërbimet që duhet të kryhen përbëhet nga e drejta për të shfrytëzuar veprat/shërbimet që janë objekt i kontratës ose nga kjo e drejtë së bashku me pagesën”

ndërsa Partneriteti Publik Privat përcaktohet si:

“...Kontratë e punëve publike apo kontratë e shërbimit publik, që plotëson kushtet, të cilat e përcaktojnë atë si një partneritet publik privat, sikurse është rregulluar në këtë ligj dhe që nënshkruhet ndërmjet autoritetit kontraktues në njërën anë dhe operatorit ekonomik të zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm.”

Sipas institucioneve ndërkombëtare koncesionet/PPP përkufizohen si:

BB² : *“... një kontratë afatgjatë lidhur midis palës private dhe palës publike për të siguruar shërbimet dhe asetet publike në të cilën pala private merr përsipër përgjegjësinë për menaxhimin e për risqeve kryesore dhe shpërblimin për performancën.”*

FMN³: *“...PPP-të i referohen marrëveshjeve sipas të cilave sektori privat siguron asete të infrastrukturës dhe shërbime të bazuara në infrastrukturë që tradicionalisht janë siguruar nga qeveria...”*

OECD (2008)⁴ : *“...një marrëveshje midis qeverisë dhe një ose më shumë partnerëve të sektorit privat (i cili mund të përfshijë operatorët dhe financuesit) sipas të cilit partnerët privatë ofrojnë shërbimin në atë mënyrë që, objektivat e ofrimit të shërbimit të qeverisë të jenë në përputhje me objektivat e fitimit të partnerëve privatë dhe ku efektiviteti i shtrirjes varet nga transferimi i mjaftueshëm i rrezikut për partnerët privatë.”*

Për vlerësimin sistematik të implikimeve të mundshme makrofiskale nga projektet me koncesion/PPP, është zhvilluar modeli PFRAM nga FMN dhe Grupi i Bankës Botërore. Ky model gjithashtu siguron një kornizë për identifikimin e risqeve fiskale të lidhura me një projekt PPP, vlerësimin e tyre dhe diskutimin e masave përkatëse zbutëse.

Më poshtë është paraqitur një përmbledhje e risqeve kryesore që përfshihen tek matrica e risqeve sipas modelit PFRAM, si dhe merren parasysh në vlerësimin e analizës së risqeve për projektet që paraqiten për miratim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

² Public Private Partnerships Reference Guide, version 3. <https://pppknowledgelab.org/guide/sections/1>, data e aksesit 20.08.2019

³ IMF(2006), “Public- private partnership government guarantees and fiscal risk”, Washington DC. URL: <https://www.imf.org/en/Publications/IMF-Special-Issues/Issues/2016/12/31/Public-Private-Partnerships-Government-Guarantees-and-Fiscal-Risk-18587>, data e aksesit 22.08.2019

⁴ OECD (2008), “Public-Private Partnerships: In Pursuit of Risk Sharing and Value for Money, Working Party on Regulatory Management and Reform”
URL: https://read.oecd-ilibrary.org/governance/public-private-partnerships_9789264046733-en#page19, data e aksesit 22.08.2019

Risqet e Kontratave Koncesionare/PPP

Risku i projektimit dhe ndërtimit: Lidhet me situatat ku ndërtimi zgjat më shumë ose kushton më shumë se sa pritej, ose që cilësia e projektimit apo e ndërtimit nënkupton se asetit nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e projektit

Risku i lejeve dhe licencave: Kostot që mund të vijnë nga risku i marrjes apo nxjerrjes së lejeve që lidhen me projektimin ndërtimin, operimin apo mirëmbajtjen e rrugës.

Risku i kërkesës: Ky risk lidhet me situatat ku përdorimi i objektit/shërbimit është i ndryshëm nga sa pritej ose të ardhurat nuk janë aq sa priten

Risku i operimit dhe performancës: Paaftësia për të shpërndarë shërbimin në sasinë dhe cilësinë e kërkuar.

Risku Financiar: Risk që lidhet me luhatjet në normën e interesit, normën e kursit të këmbimit, normën e inflacionit dhe kushtet e tjera financiare

Forca Madhore: Risqet që lidhen me ngjarjet përtej kontrollit të palëve në kontratë, të tilla si: fatkeqësitë natyrore, luftëra ose trazira civile, që ndikojnë mbi projektin.

Risku material nga vendimet politike: Kanë të bëjnë me riskun që lind si pasojë e vendimeve të dobëta politike të bërjes së procesit, stabiliteti qeveritar, kundërshtimi politik dhe shpronësimi.

Risku i ndryshimeve ligjore: Risku që një ndryshim në ligjin ose në rregullat e përgjithshme ndikon negativisht mbi projektin, të tilla si: ndryshimet në tatimet e përgjithshme të korporatave ose në rregullat që rregullojnë këmbimin e monedhës, ose riatdhesimin e fitimeve;

Risku i rinegocimit: Risk që lidhet me ndryshimet në kontratë që implikojnë kosto fiskale në buxhetin e shtetit.

Risku transferimit të aseteve: Risqet që lidhen me pronësinë e aseteve, duke përfshirë riskun që teknologjia vjetërohet ose, që vlera e aseteve në fund të kontratës është e ndryshme nga sa pritej si dhe riskun e transferimit të ndonjë detyrimi të marrë për sipër mbi asetin gjatë kohëzgjatjes së kontratës.

Risku i ndërprerjes së kontratës: Risk që rrjedh nga ndërprerja e kontratës dhe implikon kosto fiskale.

Përsa i përket vendeve në zhvillim, koncesionet/PPP kanë një rëndësi të madhe në financimin e investimeve për ndërtimin e infrastrukturës publike, përcaktuese për rritjen dhe zhvillimin ekonomik të këtyre vendeve⁵. Përvoja aktuale shqiptare në përdorimin e projekteve koncesionare/PPP-ve ka ardhur duke u përmirësuar, megjithatë ka akoma nevojë për përmirësime dhe për sigurimin e një plani strategjik kombëtar për implementimin e këtyre projekteve. Prandaj në këtë raport është synuar të jepet një pamje e përgjithshme e situatës aktuale të kontratave koncesionare/PPP aktive në vend, ku janë evidentuar të dhënat kryesore në lidhje me projektin, risqet që implikojnë, materializimin e tyre dhe impaktin që kanë pasur.

⁵ OECD (2008), “Public-Private Partnerships: In Pursuit of Risk Sharing and Value for Money, Working Party on Regulatory Management and Reform”

1.2. Kuadri Ligjor i Koncesioneve/PPP në R.Sh

Në Republikën e Shqipërisë koncepti i koncesioneve është disi më i njohur se ai i partneriteteve publike private, duke qenë se ka qenë i parashikuar më herët nga legjislacioni, ndërkohë që koncepti i PPP-së ka hyrë së fundmi në legjislacionin shqiptar me Ligjin Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat, i ndryshuar.

Legjislacioni shqiptar fillimisht i ka trajtuar koncesionet me anë të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, i cili më pas është zëvendësuar nga Ligji Nr. 9663, datë 18.12.2006, “Për Koncesionet”. Përgjatë viteve të fundit, bazuar edhe në praktikën e biznesit si edhe në përshtatje të legjislacionit dhe qasjes ndërkombëtare mbi koncesionet dhe partneritetin publik privat është miratuar një koncept më i gjerë i koncesioneve duke futur edhe përkufizimin e partneritetit publik privat, i përcaktuar tashmë edhe në dispozitat ligjore të ligjit aktual që rregullon këtë fushë, përkatësisht Ligji Nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”⁶ i ndryshuar.

Së fundmi, ky ligj ka pësuar disa ndryshime nëpërmjet Ligjit Nr.50 datë 18.07.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” i botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126 datë 13.09.2019.

Në parashikimet e reja është përforcuar roli i MFE-së nëpërmjet miratimit përfundimtar përpara nënshkrimit të draft kontratës së negociuar, kontrollit të ecurisë dhe zbatimit të të gjitha kontratave koncesionare në R.Sh., me qëllim monitorimin e vazhdueshëm të risqeve që mund t’i vijnë buxhetit të shtetit nga këto kontrata. Gjithashtu, në

këto ndryshime është parashikuar se Autoritetet Kontraktuese paraqesin, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tri herë në vit, ministrin përgjegjës për financat, raporte të përmbledhura të monitorimit të zbatimit të kontratave të koncesionit/PPP me argumentet dhe shpjegimet përkatëse. Ministria përgjegjëse për Financat mund t’iu rekomandojë autoriteteve kontraktuese marrjen e masave për përmirësimin e performancës në ofrimin e shërbimeve dhe punëve publike, objekt i këtyre kontratave, si dhe për minimizimin apo eliminimin e risqeve të drejtpërdrejta e të tërthorta që ndikojnë në buxhetin e shtetit. Legjislacioni mbi koncesionet dhe PPP, zbatohet së pari nga autoritetet kontraktuese, të cilat konsiderohen ato organe të cilave legjislacioni u jep kompetencën për të ndërmarrë dhe zbatuar procedura për dhënie të koncesioneve dhe partneriteteve publike private. Në bazë të kuadrit ligjor ekzistues, autoritetet kontraktuese konsiderohen ministrinë e linjës të qeverisjes qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Kuadri Ligjor i Koncesioneve/PPP në R.Sh

Kuadri ligjor aktual i koncesioneve dhe PPP në R.Sh mbështetet kryesisht në legjislacionin e mëposhtëm:

- Ligji nr. 50/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 125/013: Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënie me Koncesion/Partneritet Publik Privat”, i ndryshuar.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 634 datë 1.10.2014 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënie me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”.

⁶ ATRAKO (2019), “Manuali për Përdoruesit” URL: http://www.atrako.gov.al/?page_id=973


1.3. Ecuria e projekteve Koncesion/PPP në Shqipëri.

Me ndryshimet politike dhe ekonomike që ndodhën në Shqipëri pas viteve 1992, përdorimi i praktikës së partneritetit publik privat është parë si metodë alternative e leverdisshme në ofrimin e punëve dhe shërbimeve publike të cilat u trajtuan fillimisht në formën e koncesioneve. Pas viteve 2000, pati një kërkesë të madhe të aplikimit të koncesioneve/PPP nga qeveria shqiptare, me qëllim financimin e investimeve publike dhe ndërtimin e infrastrukturës publike.

Në figurën 1, është paraqitur ecuria ndër vite e kontratave koncesionare/PPP të miratuara në R.Sh, që nga viti 2004. Një ndër projektet më të rëndësishme me impakt të gjerë të kësaj periudhe konsiderohet projekti i koncesionit “Për ndërtimin e terminalit të ri në Aeroportin ‘Nënë Tereza’”, i miratuar në vitin 2004.

Më pas, gjatë viteve 2005-2013, në kuadër të privatizimit të HEC-eve vendore⁷, një numër hidrocentralesh të vegjël u privatizuan dhe disa të tjerë iu dhanë kompanive të huaja dhe vendase përmes kontratave koncesionare të tipit ROT, BOT dhe BOO. Këto kontrata kanë pasur si qëllim rehabilitimin e HEC-eve ekzistuese, operimin e tyre dhe më pas transferimin tek shteti. Njëkohësisht, me synim rritjen e kapacitetit prodhues energjitik të ekonomisë shqiptare janë nënshkruar një numër i konsiderueshëm kontratash për ndërtimin e HEC-eve të reja në burime hidrike të pashfrytëzuara. Pas vitit 2013, janë miratuar në total 46 kontrata koncesionare/PPP në sektorë me impakt të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe në sigurimin e rritjes së qëndrueshme ekonomike si në sektorin e arsimit, shëndetësisë, mjedisit dhe në kontrollin fiskal.

Figura 1: Trendi i projekteve me Koncesioneve/PPP të miratuara ndër vite, 2004-2019




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

⁷ Ligji nr.8527, datë 23.9.1999 “ Për privatizimin e hidrocentraleve vendore”.

Sikurse është paraqitur në figurën 2, pesha kumulative e investimit për projektet me koncesion/PPP ndaj PBB-së ka patur tendencë rritëse ndër vite, dhe aktualisht ky portofol përbën rreth 30% të PBB-së. Disa prej këtyre kontratave në sektorin e energjisë nuk kanë filluar akoma të zbatohen. Informacioni në lidhje me këto kontrata do të përfshihet në Raportin Vjetor të Përmbledhur.

Figura 2: Peshë kumulative e investimit për projektet me koncesion/PPP në PBB, 2004-2019




*Për vitin 2019 është marrë në konsideratë vlera e PBB nominale për periudhën Janar-Gusht 2019 (paraprake)

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)*

Për sa i përket formës së kërkuar të koncesioneve/PPP (shih figura 3), 12.6 përqind e kontratave të miratuara në total janë propozime të kërkuara nga autoritetet kontraktues, në kuadër të një procedure përzgjedhëse konkurruese. Ndërsa pjesa tjetër e kontratave të miratuara janë propozime të pakërkuara që u janë ofruar autoriteteve kontraktuese në fusha të ndryshme me qëllim ofrimin e një shërbimi/pune nëpërmjet një teknologjie të avancuar.

Megjithatë, referuar figurës 3, nga viti 2013 numri i projekteve të kërkuara nga autoritetet kontraktuese është rritur, tregues ky i fundit i rregullimit të pjesëmarrjes së sektorit privat në ofrimin e shërbimeve/punëve publike. Gjithashtu, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 50 datë 18.07.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, është kufizuar pranimi i propozimeve të pakërkuara vetëm në porte, aeroporte dhe sektorin e energjisë dhe janë hequr propozimet e pakërkuara në të gjitha fushat e dhënies me koncesion/PPP që përcakton Ligji Nr. 125/2013, i ndryshuar.


Figura 3: Projekte Koncesion/PPP të kërkuara dhe të pakërkuara (Nr.), 2004-2019



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Referuar figurës 4, numri total i kontratave koncesionare/PPP të miratuara për periudhën 2004-2013 shënon vlerën 176 në total, ndërsa gjatë periudhës 2014-2019 janë miratuar 46 kontrata koncesionare/PPP ose 74 përqind më pak krahasuar me periudhën 2004-2013.

Figura 4: Numri total i kontratave koncesionare/PPP të miratuara për periudhat 2004-2013 dhe 2014-2019




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Në total, numri i kontratave të dhëna me koncesion/PPP në R.Sh deri në vitin 2019 shënon 222 kontrata, ku numri më i madh i tyre ka si Autoritet Kontraktues Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, rreth 92.3 përqind të totalit (shih Figura 5). Ndërkohë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është Autoritet Kontraktues në 4 kontrata koncesionare në fushën e shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është Autoritet Kontraktues në 6 kontrata koncesionare në fushën e kontrollit fiskal dhe në fushën e zhvillimit ekonomik, Bashkia e Tiranës është Autoritet Kontraktues në 2 kontrata koncesionare,

ndërsa Ministrinë e tjera të linjës dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore kanë në fushën e tyre të përgjegjësisë nga 1 kontratë koncesioni/PPP respektivisht secila.


Figura 5: Numri i kontratave Koncesionare/PPP sipas Autoritetit Kontraktues, 2019



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Referuar figurës 6, sektori që ka peshën më të madhe të kontratave në numër dhe në vlerë është sektori i energjisë me 186 kontrata, me vlerë 418.5 miliardë lekësh. Të gjitha kontratat koncesionare të këtij sektori janë të llojit BOT, ROT dhe BOO. Kontratat me peshën më të madhe ndaj totalit të vlerës së këtij sektori janë kontratat koncesionare “Për ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit Kaskada e Devollit” dhe “Hidrocentral Ashta”.

Figura 6: Numri dhe vlera totale e investimit (në lekë) të projekteve Koncesionare/PPP aktive sipas sektorëve, 2019



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Sektori i dytë me peshë më të madhe përta i përket vlerës së kontratave është sektori i transportit, me rreth 8 përqind të totalit të numrit të kontratave (17 kontrata respektivisht) si dhe me vlerë 67.5 miliardë lekë. Kontratat me vlerën më të lartë në këtë sektor janë “Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi i Aeroportit ‘Nënë Tereza’, “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot-Morinë” dhe “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit


Sektori i mjedisit ndërkohë ka në total 6 kontrata me vlerë 25.8 miliardë lekësh të cilat konsistojnë në ngritjen e sistemit të përpunimit të mbetjeve, menaxhimin e pyjeve, si dhe shfrytëzimin e burimeve ujore. Kontrata me vlerën më të lartë në këtë sektor është kontrata “Për Ndërtimin e Landfillit, Inceneratorit dhe rehabilitimin e Venddepozitimeve ekzistuese, Tiranë”.

Përta i përket Sektorit të Shëndetësisë, në total ka 4 kontrata koncesionare/PPP me vlerë prej 4.1 miliardë lekësh. Kontrata me vlerën më të lartë në këtë sektor është kontrata koncesionare/PPP “Për shërbime të integruara për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, si dhe trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”

Ndërsa, në kategorinë ‘Të tjerë’, janë përfshirë në total 8 kontrata koncesionare me vlerë 10.3 miliardë lekë të shpërndara në sektorin e bujqësisë, sektorin e tatimeve dhe doganave, sektorin e zhvillimit ekonomik dhe sektorin e arsimit.

Përta i përket llojit të mbështetjes financiare nga sektori publik në total janë 14 kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore apo rreth 6 përqind e totalit të kontratave. Ndërsa kontratat pa mbështetje buxhetore janë në total 207 të tilla apo 94 përqind e totalit të kontratave koncesionare/PPP të miratuara (shih figura 7).

Figura 7: Projekte Koncesion/PPP me dhe pa mbështetje buxhetore (në total nr.)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Referuar figurës 8 mbi pagesat buxhetore për kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, në vitin 2018 janë realizuar 8.7 miliardë lekë, me një peshë prej 2.2 përqind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor.

Kosto faktike për 9 mujorin e vitit 2019 për këto 14 Koncesione/PPP, që financohen nga buxheti i shtetit është 10.2 miliardë lekë, pra rreth 2.4 përqind e të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor, duke qëndruar kështu brenda kufirit të rregullit fiskal maksimal prej 5 përqind e të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor. Pagesat buxhetore të planifikuara për vitin 2019 në total janë 12.4 miliardë.

Figura 8: Pagesat buxhetore për kontratat me mbështetje buxhetore⁸




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

⁸ Për vitin 2018 dhe 9-mujorin e vitit 2019 pagesat buxhetore fakt, ndërsa për vitet e tjera janë të parashikuara.

Ndërkohë, referuar figurës 9 përpjesa e pagesave buxhetore ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor, ka rezultuar për vitin 2018 dhe 9-mujorin 2019 nën kufirin maksimal të rregullit fiskal prej 5 përqind. Gjithashtu në bazë të pagesave buxhetore të planifikuara ky tregues parashikohet të jetë edhe për vitet në vijim nën kufirin maksimal të rregullit fiskal.

Figura 9: Përpjesa e pagesave buxhetore ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor⁹



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

2. Prezantim i ecurisë së 10 Kontratave Koncesionare/PPP në Shqipëri

Në total në Shqipëri deri në vitin 2019 rezultojnë 222 kontrata koncesionare, por meqënëse procesi i monitorimit të të gjitha kontratave koncesionare në R.Sh është një proces i iniciuar në vitin 2019 me miratimin e ndryshimeve të Ligjit Nr. 125/2013 i ndryshuar, në këtë seksion të raportit do të përshkruhet ecuria e 10 prej tyre që kanë vlerën më të lartë monetare në sektorët respektivë.

❖ Sektori i Transportit

Me qëllim rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë kombëtare, Qeveria e Shqipërisë në vitin 2017 ka iniciuar programin ‘One Billion Project Financing Program’ i cili fokusohet në implementimin e projekteve në infrastrukturë dhe turizëm me impakt të madh social dhe ekonomik. Në kuadër të këtij programi është investuar në ndërtimin e akseve rrugore me rëndësi kombëtare për zhvillimin ekonomik, nga të cilat në këtë raport janë përzgjedhur për t’u prezantuar kontratat si më poshtë:

⁹ Për vitin 2018 dhe 9-mujorin e vitit 2019 përpjesa e pagesave buxhetore ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor është fakt, ndërsa për vitet e tjera kjo përpjesë është e parashikuar në bazë të pagesave buxhetore të planifikuara..

2.1. Kontrata Koncesionare/PPP “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot-Morinë”

2.1.1. Përshkrim i përgjithshëm i projektit

Ky projekt koncesionar është pjesërisht me mbështetje financiare nga buxheti i shtetit dhe është realizuar nga bashkëpunimi i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues dhe shoqërisë koncesionare “Albania Highway Concession Company”, me një kohëzgjatje prej 30 vitesh. Objekti i këtij projekti Koncesion/PPP është përmirësimi i Autostradës Milot-Morinë, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja efikase e saj. Koncesionari do të përmirësojë, operojë dhe mirëmbajë Autostradën sipas një pakete të paracaktuar të standardeve të performancës për një periudhë 30 vjeçare të koncesionit. Data efektive e kontratës është data 09.09.2017.

Nëpërmjet këtij projekti është synuar zgjidhja e një problemi të rëndësishëm përse i përket mirëmbajtjes në tërësi të një aksi rrugor kombëtar i cili kërkon fonde të konsiderueshme për t’u mirëmbajtur për shkak të terrenit malor dhe dimrit të ashpër me rreshje, si dhe kostove të konsiderueshme të mirëmbajtjes dhe operimit të Tuneleve të Thirrës.

Partneri privat është përgjegjës gjatë periudhës së koncesionit për ndërtimin dhe operimin e autostradës, mirëmbajtjen dhe operimin e tunelit të Thirrës, operimin e një sistemi të tarifës së rrugës dhe mbledhjes së të ardhurave nga tarifa e rrugës.

2.1.2. Performanca e projektit dhe lloji i financimit

Aktualisht projekti është në fazën e ndërtimit dhe të operimit. Ndërtimi për këtë projekt pritet të realizohet në katër vite (deri në vitin 2022). Realizimi punimeve të ndërtimit për vitin 2018 ka qenë 20 përqind. Për shkak të protestave kundër pagesës së tarifës së kalimit për përdorim të rrugës, të cilat çuan në shkatërrimin e sheshit të Pagesës (Toll Plaza) ky shesh doli për 6 muaj jashtë funksionit.

Kontrata Koncesionare “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot-Morinë”

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- **SPV:** “Albania Highway Concession Company”
- **Vlera e Investimit:** 5,3 miliardë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 09 Mars 2017
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 30 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Ndërtim dhe Operim



Deri më tani përgjatë vitit 2019 është realizuar 48 përqind e punimeve të ndërtimit. Aktualisht kompania vazhdon të realizojë në mënyrë të pandërprerë punimet e mirëmbajtjes së autostradës “Milot-Morinë”, ka kryer punime përmirësuese përgjatë kësaj autostrade, ka përmirësuar dhe rritur nivelin e sigurisë në Tunelin e Thirrës, ka realizuar mirëmbajtjen dimërore dhe ka rehabilituar elementë të autostradës. Sipas raportimeve, gjatë zbatimit të kësaj kontrate nuk ka patur kapërcim të afateve kontraktuale nga ana e shoqërisë koncesionare dhe si rezultat nuk janë aplikuar penaltitete.

Meqënëse kjo kontratë koncesionare/PPP është pjesërisht me mbështetje buxhetore, në tabelën 1 janë dhënë vlerat e pagesave nga buxheti i shtetit të realizuara për vitin 2018 dhe të planifikuara për vitet 2019-2021. Për 9-mujorin e vitit 2019, financimi nga buxheti i shtetit ka qënë në vlerën 315.6 milion lekë, me një realizim prej 46.1 përqind nga plani vjetor 2019 prej 685 milion lekë.

Tabela 1: Pagesat buxhetore për projektin “Milot-Morinë”

Viti	2018		2019		2020	2021
	Plan	Fakt	Plan	Fakt-9 mujor	Projektuar	Projektuar
Pagesat Buxhetore (në mijë lekë)	310,000	308,183	685,000	315,621	720,000	720,000

Ndërkohë në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhëna mbi të ardhurat e realizuara nga tarifat e përdoruesve të rrugës. Ndërkohë për 9-mujorin e vitit 2019 janë realizuar 1,428 milionë lekë ose 6 përqind më shumë se sa vlera e projektuar vjetore.

Tabela 2: Të ardhurat nga tarifat e përdoruesve të rrugës “Milot-Morinë”

Viti	2018		2019		2020	2021
	Plan	Fakt	Plan	Fakt-9 mujor	Projektuar	Projektuar
Niveli i të ardhurave (në mijë lekë)	1,158,554	402,761	1,344,380	1,428,315	1,056,316	1,072,525

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur vlera e investimit e planifikuar dhe faktike e kryer nga shoqëria koncesionare. Për vitin 2018, vlera e investimit e realizuar ka rezultuar rreth 17 përqind më e madhe se sa ajo e parashikuar. Ndërsa për 9-mujorin e vitit 2019 raportohet se vlera e punimeve të kryera nga shoqëria ka qënë 1,044 milionë lekë ose 48 përqind e totalit vjetor të planifikuar.


Tabela 3: Vlera e investuar ndër vite

Viti	2018		2019		2020	2021
	Plan	Fakt	Plan	Fakt-9 mujor	Projektuar	Projektuar
Vlera e investimit (në mijë lekë)	1,127,105	1,316,816	2,161,589	1,044,183	2,625,000	843,750

2.1.3. Risqet

Autoriteti ka raportuar në lidhje me risqet e kontratës sipas formatit të përcaktuar, duke specifikuar përcaktimin e palës që merr përsipër riskun, impaktin fiskal nëse është materializuar, probabilitetin e ndodhjes në të ardhmen dhe impaktin e pritshëm nëse ndodh. Kështu nga 12 risqe të identifikuara, Autoriteti Kontraktues ka mbajtur 3 risqe: riskun politik, riskun e qeverisjes dhe riskun e ndryshimeve ligjore, ndërsa tek Partneri Privat janë transferuar risku i ndërtimit, risku i transferimit të asetëve, risku i operimit dhe performancës dhe risku i ribalancimit të ekuilibrit financiar. Ndërkohë, risku i kërkesës, risku financiar, risku i forcës madhore, risku i rinegocimit dhe risku i ndërprerjes së kontratës janë ndarë mes palës private dhe publike.

Figura 10: Alokimi i risqeve në kontratën e koncesionit/PPP “Milot-Morinë”



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (2019)

Në vitin 2018, për shkak të kundërshtimeve mbi tarifën e rrugës nga përdoruesit e rrugës si dhe nga banorët e qytetit të Kukësit, Sheshi i Pagesës (Toll Plaza) qëndroi për 6 muaj jashtë funksionit. Megjithatë, për muajt operativ të ardhurat ishin më të larta se ato të parashikuara. Nga rakordimi vjetor për vitin 2018 raportohet se niveli i të ardhurave faktike ka rezultuar më i lartë se minimumi i të ardhurave të garantuara nga trafiku, si rrjedhojë në bazë të kontratës nga ky suficit i të ardhurave të realizuara Autoriteti Kontraktues ka patur përfitimi duke bërë ndarjen e këtij suficiti me Shoqërinë koncesionare në raportin 60:40.

2.2. Kontrata Koncesionare/PPP “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit”

2.2.1. Prezantimi i përgjithshëm i projektit

Me anë të kësaj kontrate Partneriteti Publik Privat, shteti shqiptar ka mundësuar ndërtimin e një aksi rrugor të rëndësishëm për Qarkun e Dibrës, i cili ka si qëllim nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social të popullatës së kësaj zone, si dhe do të mundësojë një akses më të madh në shkëmbimet tregtare me vendin fqinj Maqedoninë. Kjo kontratë ka një kohëzgjatje prej 13 vitesh dhe data efektive e saj është data 04.07.2018.

Në këtë kontratë PPP, shoqëria koncesionare ka marrë përsipër të ndërtojë jo vetëm segmentin prej 26.8 km i cili përfshin ndërtimin e një tuneli, por edhe përmirësimin për punimet e kryera që prej vitit 2012 kur ky aks nisi të ndërtohej, dhe që për mungesë fondesh u bë pre e amortizimit.

Ndërtimi i kësaj rruge shkurton distancën nga Tirana për në Dibër të Maqedonisë, nga 180 km në 75 km. Kjo rrugë do të bëhet një korridor lidhës i rëndësishëm drejt Lindje-Perëndimit, dhe më tej drejt Bullgarisë dhe Rumanisë etj. Me ndërtimin e kësaj rruge synohet të përmirësohet efikasiteti i transportit, minimizimi i aksidenteve rrugore brenda rajonit të projektit dhe në mënyrë efektive rritja e sigurisë rrugore, perspektivës së zhvillimit turistik të zonës si dhe standardeve të jetesës në të gjithë zonën.

Kontrata Koncesionare “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit”	
• Autoriteti Kontraktues:	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
• SPV:	“Gjoka 87 sh.p.k”
• Vlera e Investimit:	26.5 miliardë Lek
• Data e fillimit të kontratës:	11 Korrik 2018
• Kohëzgjatja e kontratës:	13 vjet
• Faza aktuale e projektit:	Ndërtim



2.2.2. Performanca e projektit dhe lloji i financimit

Sipas raportimeve, aktualisht projekti është në fazën e ndërtimit, i cili po realizohet me hapa më të shpejtë se sa ishte parashikuar. Ndërtimi për këtë projekt është parashikuar të realizohet në katër vite (2018- 2022). Për vitin 2018 janë realizuar 25% e volumit të punimeve ose 11 pikë përqindje më shumë se sa objektivi i synuar për vitin 2018. Ndërsa deri në tremujorin e dytë të vitit 2019 është realizuar 40 përqind e ndërtimit ose 12 pikë përqindje më shumë se sa ishte parashikuar të realizohej gjatë kësaj periudhe.

Përsa i përket llojit të financimit ky projekt koncesionar/PPP është me mbështetje buxhetore, pagesat e të cilit fillojnë nga viti 2019 (shih tabela 4). Autoriteti Kontraktues ka përmbytur detyrimin e pagesës për realizimin e punimeve të ndërtimit mbi 25 përqind të ecurisë së punimeve dhe do të kryejë pagesat në vijim sipas modelit financiar.

Pagesat faktike të 9-mujorit 2019 janë në masën rreth 2.6 miliardë lekë, duke rezultuar me një realizim prej 96.7 përqind nga plani vjetor 2019 prej 2.7 miliardë lekë.

Për vitin 2019 plani vjetor prej 2.7 miliardë lekë është i ndarë në:

- 2.52 miliard lekë për “Ndërtim, Operim, Mirëmbajtje”,
- 181.5 milion lekë për “Supervizionin” e kësaj kontrate.

Për ‘Ndërtim, Operim, Mirëmbajtje’, pagesat faktike të 9-mujorit 2019 janë në masën 2.52 miliardë lekë duke rezultuar 100 përqind të planit vjetor.

Për Supervizionin, pagesat faktike të 9-mujorit të vitit 2019 janë në masën 92.3 milionë lekë, duke rezultuar 50.9 përqind të planit vjetor.

Tabela 4: Pagesat buxhetore për projektin “Rruga e Arbrit”

Viti	2018		2019		2020	2021
	Plan	Fakt	Plan	Fakt-9 mujor	Projektuar	Projektuar
Pagesat Buxhetore (në mijë lekë)	1,000	0	2,701,000	2,612,316	3,925,000	3,325,000

Ndërsa në tabelën 5 janë paraqitur të dhënat mbi vlerën e investimit kapital të realizuar nga viti 2018. Shpronësimet e porealizuara, kushtet klimaterike dhe problemet gjeologjike të tunelit të Murrizit, kanë qënë pengesë e realizimit me normë më të shpejtë të investimeve. Për vitin 2018 investimi është realizuar në vlerën 6,94 miliardë lekë, pra 100.3% më shumë se vlera e parashikuar për t’u investuar gjatë këtij viti, duke bërë që investimet në ndërtimin e rrugës të realizohen më shpejt se sa ishte parashikuar.

Ndërkohë, për 9-mujorin e vitit 2019, vlera e realizuar e investimit përbën 38.8% të vlerës totale të parashikuar për tu investuar gjatë këtij viti.


Tabela 5: Vlera e investimit “Rruga e Arbrit”

Viti	2018		2019		2020	2021
	Plan	Fakt	Plan	Fakt- 9 mujor	Projektuar	Projektuar
Investimi Kapital (në mijë lekë)	3,465,000	6,942,007	7,363,123	2,857,035	7,796,200	7,796,200

2.2.3. Risqet

Autoriteti ka raportuar në lidhje me risqet e kontratës sipas formatit të përcaktuar, duke specifikuar përcaktimin e palës që merr përsipër riskun. Raportohet se Autoriteti Kontraktues ka mbajtur 3 prej tyre: riskun politik, riskun e aksesit në zonën e projektit dhe riskun e ndryshimeve ligjore, ndërsa tek Partneri Privat janë transferuar 5 risqet kryesore si: risku i projektimit, ndërtimit, disponueshmërisë, risku i operimit dhe mirëmbajtjes, risku i transferimit të aseteve dhe risku i ribalancimit të ekuilibrit financiar. Ndërkohë, risku i forcës madhore, risku i rinegocimit dhe risku i ndërprerjes së kontratës janë ndarë mes palës private dhe publike.

Figura 11: Alokimi i risqeve në kontratën e koncesionit/PPP “Rruga e Arbrit”



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (2019)

Gjatë zbatimit të kësaj kontrate nga Autoriteti Kontraktues nuk është raportuar materializimi i ndonjë risku, por vetëm se shpronësimet dhe procedurat administrative mund të shkaktojnë vonesa në afatet e ndërtimit dhe sipas kontratës kjo mund të përbëjë “Shkak Lehtësimi”. Nuk është aplikuar penalitet.

2.3 Kontrata Koncesionare/PPP “Ndërtimi, vënia në punë, operimi dhe mirëmbajtja e aeroportit ‘Nënë Tereza’ ”

2.3.1. Prezantimi i përgjithshëm i projektit

Aeroporti i Rinasit, sot i quajtur Tirana International Airport "Nënë Tereza" është ndërtuar gjatë periudhës kohore 1955-1957. Aeroflot, Jat, Malev, Tarom dhe Interflug, ishin kompanitë ajrore që operonin në Shqipëri deri në vitin 1960. Trafiku arrinte deri në dy fluturime në ditë. Mbas vitit 1960 deri në vitin 1978, shoqëri të shumta ajrore ndërprejnë operimet e tyre në Shqipëri, për shkak të izolimit politik të vendit mbas ndërprerjes së marrëdhënieve diplomatike me Bashkimin Sovjetik, i cili solli si rezultat një ulje të numrit të pasagjerëve dhe fluturimeve.

Si rrjedhojë e ndryshimeve politike dhe sociale në Shqipëri gjatë viteve 1992 - 2000 u rrit numri i fluturimeve dhe kompanive ajrore që operonin në Shqipëri. Duke u ballafaquar me nevojat për zhvillim të mëtejshëm të Tirana International Airport "Nënë Tereza", Këshilli i Ministrave vendosi të shpallë për investitorët ndërkombëtarë ndërtimin e një terminali të ri dhe shërbimeve të tjera, si dhe operimin e aeroportit. Procedurat konkurruese u mbyllën në fund të vitit 2003 dhe

në datën 23 Prill 2005 Tirana International Airport filloi operimet tek Tirana International Airport "Nënë Tereza". Ky projekt ka një kohëzgjatje prej 22 vitesh, me maksimum kohëzgjatje 4.5 vjet në varësi të operimit të një aeroporti të ri tregtar.

Projekti konsiston në zhvillimin e dy fazave A dhe B ku përfshihet projektimi, financimi, operimi, ndërtimi, vënia në punë, mirëmbajtja dhe administrimi/zhvillimi i terminalit të ri të aeroportit, duke lejuar zgjerimin e tij në të ardhmen.

Gjithashtu projekti ka patur si qëllim administrimin, operimin, mirëmbajtjen e të gjithë anës ajrore dhe infrastrukturës (përveç kontrollit të trafikut ajror, por duke përfshirë Lëvizjen në Tokë dhe Shërbimet e Lidhura). Gjithashtu me anë të këtij projekti është synuar modernizimi i ambienteve të kargos dhe përpunimit tokësor, përmirësimi i rrugëve lidhëse si dhe mirëmbajtja dhe zgjerimi i Pistës, duke përfshirë projektimin, financimin, operimin, ndërtimin, vënien në punë, mirëmbajtjen, administrimin dhe zhvillimin e kësaj infrastrukture. Me anë të këtij projekti, synohet të realizohet ndërtimi dhe vënia në punë e rrugës së re hyrëse, si dhe zëvendësimi i urës ekzistuese me rrugën, e cila lidh aeroportin me urën e re si dhe

Kontrata Koncesionare “Ndërtimi, vënia në punë, operimi dhe mirëmbajtja e aeroportit “Nënë Tereza”

- **Autoriteti Kontraktues:** OSHA (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë)
- **SPV:** Tirana International Airport sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 9.1 miliardë Lekë
- **Data e fillimit të kontratës:** 23 Prill 2005
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 22 vite
- **Faza aktuale e projektit:** Operim& Ndërtim



zhvendosjen e radarit dytësor ekzistues në rast se kërkohet, në lidhje me projektin dhe në marrëveshje paraprake me ANTA-n.

2.3.2. Performanca e projektit dhe lloji i financimit

Aktualisht projekti është në fazën e operimit. Shoqëria koncesionare TIA shp.k, ka dorëzuar Masterplanin e përditësuar të Aeroportit në përputhje me kërkesat e vendosura në Shtojcën 18 të marrëveshjes koncesionare (Master Plani dhe Planifikimi i Mjediseve). Përgjatë dy fazave është realizuar ripërtëritja, vënia në punë dhe mirëmbajtja e terminalit ekzistues në përputhje me kërkesat e vendosura në Shtojcën 21 të marrëveshjes koncesionare (Terminali Ekzistues), si dhe ka përfunduar ndërtimi dhe vënia në punë e qendrës së re të kargos në përputhje me kërkesat e vendosura në Shtojcën 22 të marrëveshjes koncesionare (Faza A e Qendrës së Re të Kargos). Janë përmirësuar rrugët lidhëse të pistës, vendqendrimet e avionëve dhe rrugët lidhëse në përputhje me kërkesat e vendosura në Shtojcën 23 të marrëveshjes koncesionare (Infrastruktura e Anës Ajrore). Është përfunduar dhe mirëmbajtur Perimetri i Rrethimit të Sigurisë së Aeroportit në përputhje me kërkesat e vendosura në kontratë. Autoriteti ka raportuar në lidhje me realizueshmërinë e indikatorëve të performancës si më poshtë:

Indikatorët kryesorë të performancës	Realizueshmëria
Kriteret e Përbushjes së performancës në zbatim të shtojcës 36 të Marrëveshjes së Koncesionit	90 përqind
Infrastruktura nga ana e aerodromit, zgjerimi i rrugëve lidhëse	100 përqind
Pajisjet e Aerodromit, funksionimi dhe mirëmbajtja e pasjisjeve	100 përqind
Ndriçimi tokësor i Aerodromit	100 përqind
Mjetet kundra zjarrit, shpëtimit dhe kontrollet përkatëse	85 përqind
Manuali Operacional i Aeroportit	100 përqind
Implementimi i plotë i sistemit të Menaxhimit të Sigurisë nga koncesionari	60 përqind
Mirëmbajtja e Aerodromit	100 përqind
Administrimi Mjedisor	100 përqind
Impianti i ri i karburantit	100 përqind
Siguria dhe Siguria Teknike	80 përqind

Një tjetër tregues i performancës së këtij projekti është trendi në rritje ndër vite i numrit të pasagjerëve që kanë përdorur shërbimin e ofruar nga ky koncesion. Statistikat që nga viti 2012 janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:


Tabela 6: Numri i pasagjerëve ndër vite

Viti	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	8-mujori 2019
Nr.i Pasagjerëve	1,665,331	1,757,342	1,810,305	1,977,044	2,195,100	2,630,338	2,947,172	2,222,029

2.3.3. Risqet

Autoriteti ka raportuar në lidhje me risqet e kontratës sipas formatit të përcaktuar, duke specifikuar përcaktimin e palës që merr përsipër riskun, impaktin fiskal nëse është materializuar, probabilitetin e ndodhjes në të ardhmen dhe impaktin e pritshëm nëse ndodh. Kryesisht është raportuar probabilitet i ulët për riskun e qeverisjes, riskun e ndërtimit, riskun e kërkesës, riskun financiar dhe riskun e ndërprerjes së kontratës. Gjithashtu edhe risku material nga vendimet politike dhe risku i ndryshimeve ligjore është vlerësuar me probabilitet mesatar për të ndodhur.

Figura 12: Alokimi i risqeve në kontratën e koncesionit/PPP “Aeroporti Nënë Tereza”



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Aviacionit Civil (2019)

Sipas raportimeve të bëra nga Autoriteti i Aviacionit Civil lidhur me risqet e tjera të kontratës është vlerësuar një nivel risku mesatar për disa tregues si më poshtë:

Për riskun e operimit dhe performancës, ka rezultuar mosimplementim i plotë i sistemit të menaxhimit të sigurisë nga TIA i operimit të aeroportit. Gjithashtu, zbatimi i standardeve të sigurisë së aviacionit është konsideruar me risk të mesëm për shkak të rezultateve të shtrira në kohë të monitorimit të këtyre standardeve. Në lidhje me këtë risk AAC ka kërkuar nga TIA marrjen e veprimeve korrigjuese dhe është në monitorim të vazhdueshëm të adresimit të gjetjeve lidhur me sigurinë në aviacion.

Për riskun e disbalancimit të ekuilibrit financiar, është raportuar se është vlerësuar si mesatar bazuar në parashikimet e Kontratës së Koncesionit, pika 19 e saj dhe ecurisë ndër vite të treguesve të caktuar, krahasuar me parashikimet fillestare të kryera nga shoqëria. Lidhur me këtë, për të vlerësuar nëse ka ose jo një disekuilibër ekonomik referuar totalit të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe normës së kthimit të kapitalit sipas skenarit bazë është kontraktuar një kompani ndërkombëtare për kryerjen e rishikimit të pavarur të pozicionit ekonomik/disbalancës ekonomike e cila ka konstatuar se shifrat tregojnë një disbalancë ekonomike. Lidhur me këtë disbalancë ekonomike janë në diskutim e sipër opsionet e mundshme të rinegocimit të cilat do të synojnë ofrimin e një shërbimi sa më të mirë për përdoruesit.

Për riskun e rinegocimit, raportohet i vlerësuar si i mesëm lidhur me disbalancën ekonomike të kontratës por jo vetëm, megjithatë ky rinegocim ende nuk është materializuar.

❖ Sektori i Mjedisit

Në sektorin e mjedisit janë miratuar tre projekte PPP (Inceneratori i Tiranës, Inceneratori i Fierit dhe Inceneratori i Elbasanit), të cilat konsistojnë në ndërtimin e një impianti të përpunimit të mbetjeve urbane, si dhe synojnë gjenerimin e energjisë elektrike për popullsinë në të ardhmen. Këto projekte janë në linjë me politikat e Qeverisë dhe Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve, e cila përcakton një hierarki për parandalimin dhe administrimin e tyre që janë: parandalimi, përgatitja për ripërdorim, riciklimi, rikuperime të tjera dhe asgjësimi.¹⁰


2.4. Kontrata Koncesionare/PPP “Për Ndërtimin e Landfillit, Inceneratorit dhe rehabilitimin e Venddepozitimeve ekzistuese, Tiranë”

2.4.1. Prezantimi i përgjithshëm i projektit

Projekti koncesionar ka si qëllim ndërtimin e landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimin e venddepozitimeve ekzistuese Tiranë, me Autoritet Kontraktues MIE, ka një kohëzgjatje prej 30 vjetësh (2017-2047) dhe kosto totale të investimit prej 18.9 miliardë Lekë. Data efektive e kësaj kontrate është data 31.08.2017. Nëpërmjet këtij koncesioni, MIE synon që të japë një zgjidhje të qëndrueshme të problemit të menaxhimit aktual të mbetjeve në Qarkun e Tiranës. Nëpërmjet këtij koncesioni është vënë në dispozicion të Bashkisë Tiranë një incenerator i standardeve bashkëkohore, i cili po mundëson trajtimin profesional të mbetjeve urbane të kësaj Bashkie, dhe gjithashtu është planifikuar krijimi i mundësisë që këto mbetje në të ardhmen të gjenerojnë energji elektrike për popullatën. Në fund të periudhës së këtij koncesioni, Bashkisë së Tiranës i kalohet në pronësi dhe në përdorim ky aset i rëndësishëm, i cili jo vetëm do të përmirësojë dukshëm cilësinë e mjedisit por edhe do të mundësojë gjenerimin e të ardhurave shtesë si pasojë e shitjes së energjisë elektrike në sistemin elektroenergjitik shqiptar.

Kontrata Koncesionare “Për Ndërtimin e Landfillit, Inceneratorit dhe rehabilitimin e Venddepozitimeve ekzistuese, Tiranë”

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- **Autoritet i Përfshirë:** Bashkia e Tiranës dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore Qarku Tiranë
- **SPV:** “Integrated Energy BV SPV”
- **Vlera e Investimit:** 17,1 miliardë Lekë
- **Data e fillimit të kontratës:** 31 Gusht 2017
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 30 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Ndërtim & Operim



2.4.2. Performanca e projektit dhe lloji i financimit

Aktualisht projekti është në fazën e ndërtimit. Ndërtimi për këtë projekt pritet të realizohet në

¹⁰ VKM nr.175, datë 19.01.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe Planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”

gjashtë vite (2018-2024) dhe deri në fund të vitit 2018 është realizuar 6 përqind e ndërtimit nga 30 përqind të projektuara për tu realizuar për shkak të problemeve me lëshimin e lejeve.

Aktualisht është marrë në dorëzim venddepozitimi i mbetjeve urbane ekzistuese dhe po vazhdohet me menaxhimin e mbetjeve, dherave dhe inerteve.

Gjithashtu është aplikuar dhe marrë leja e ndërtimit në Këshillin Kombëtar të Territorit për objektet përbërëse të impiantit, konform projektit.

Lidhur me treguesit e performancës për këtë kontratë, janë raportuar:

- Ndërtimi i Inceneratorit - Lidhur me këtë tregues raportohet mbi mosrealizimin e tij për shkak të lejes së ndërtimit, e cila ende nuk është marrë, ndërkohë që dokumentacioni është dorëzuar.
- Kapsulimi i mbetjeve në landfillin ekzistues – Për periudhën 9 mujore ky tregues raportohet të jetë realizuar 100 përqind.

Përsa i përket llojit të financimit, sipas kontratës koncesionare ky projekt koncesionar/PPP është me pagesa për tarifë/ton për depozitimin e mbetjeve e cila paguhet nga Njësitë e Qeverisjes Vendore Qarku Tiranë për mbetjet që depozitohen, pagesat e të cilit kanë filluar nga viti 2018 në vlerën reale 977 milionë lekë (shih tabela 7).

Për periudhën 9 mujore të vitit 2019, pagesat faktike janë realizuar në masën 767.1 milionë lekë, pra në masën 100 përqind të planit vjetor.

Tabela 7: Pagesat e tarifës për ton mbetje për projektin “Inceneratori i Tiranës”

Viti	2018		2019		2020	2021
	Plan	Fakt	Plan	Fakt-9-mujor	Projektuar	Projektuar
Pagesat e tarifës për ton (në mijë lekë)	977,000	977,000	767,125	767,125	998,410	1,165,124

Referuar tabelës 8, vlera faktike e investimit kapital për vitin 2018 ka qënë vetëm 20 përqind e vlerës së planifikuar në planin e biznesit. Arsyeja që ka çuar në mosrealizim të vlerës së investimit ka qënë koha e gjatë e marrjes së lejes së ndërtimit në KRT për objektet përbërëse të impiantit. Ndërsa vlera e investimit kapital për 9-mujorin e vitit 2019 ka shënuar 301 milionë lekë.

Tabela 8: Vlera e investimit për projektin “Inceneratori i Tiranës”

Viti	2018		2019		2020	2021
	Plan	Fakt	Plan	Fakt-9 mujor	Projektuar	Projektuar
Investimi Kapital (në mijë lekë)	5,691,735	1,172,336	5,938,677	301,030	2,989,057	1,554,742

Referuar tabelës Nr.9, sasia e mbetjeve të depozituara për vitin 2018, ka rezultuar 14 përqind më shumë se sa niveli minimal vjetor i parashikuar. Gjithashtu, për 9-mujorin e vitit 2019 sasia e mbetjeve të depozituara ka qënë 19 përqind më shumë se sa niveli minimal vjetor për këtë vit.


Tabela 9: Niveli i kërkesës

Viti	2018		2019		2020	2021
	Plan	Fakt	Plan	Fakt-9 muor	Projektuar	Projektuar
Niveli i kërkesës (në ton)	200,750	228,761	200,750	239,188	200,750	237,250

2.4.3. Risqet

Autoriteti ka raportuar në lidhje me risqet e kontratës sipas formatit të përcaktuar, duke specifikuar përcaktimin e palës që merr përsipër riskun, impaktin fiskal nëse është materializuar, probabilitetin e ndodhjes në të ardhmen dhe impaktin e pritshëm nëse ndodh. Kështu nga risqet e identifikuar, Autoriteti Kontraktues ka mbajtur riskun e vendodhjes, riskun politik dhe riskun ekonomik, ndërsa partneri privat ka mbajtur riskun financiar, riskun e projektimit dhe riskun e transferimit të asetëve. Ndërkohë, risku i lejeve dhe licensave, risku i forcës madhore, risku i rinegocimit dhe risku i ndërprerjes së kontratës janë ndarë mes të dyja palëve. Lidhur me zgjatjen e afateve të ndërtimit që përfshihet si element i riskut të ndërtimit, raportohet se kjo zgjatje afati është shkaktuar si rrjedhojë e vonësve në dhënien e lejeve.

Figura 13: Alokimi i risqeve në kontratën e koncesionit/PPP “Inceneratori i Tiranës”



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , Bashkia Tiranë (2019)

2.5. Kontrata Koncesionare/PPP “Për ndërtimin e administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier dhe prodhimin e Energjisë”

2.5.1. Prezantimi i përgjithshëm i projektit

Ky projekt koncesionar i formës BOT i nënshkruar mes MIE si Autoritet Kontaktues dhe subjektit “Integrated Technology Waste Treatment Fier” sh.p.k, ka si qëllim financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin dhe mirëmbajtjen e impiantit të përpunimit të mbetjeve të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë. Projekti ka një kohëzgjatje prej 6 vjetësh dhe kosto totale të investimit prej 3.72 miliardë Lekë. Data efektive e kësaj kontrate është data 30 Nëntor 2016.

Nëpërmjet këtij koncesioni, MIE synon që të japë një zgjidhje të qëndrueshme të problemit të menaxhimit aktual të mbetjeve në qytetin e Fierit.

Sipas raportimeve edhe në këtë rast, në fund të periudhës së këtij koncesioni, Bashkisë Fier i kalohet në pronësi dhe përdorim ky aset i rëndësishëm, i cili jo vetëm që do të përmirësojë dukshëm cilësinë e mjedisit por edhe do të mundësojë gjenerimin e të ardhurave shtesë si pasojë e shitjes së energjisë elektrike në sistemin elektroenergjitik shqiptar.

Kontrata Koncesionare “Për ndërtimin e administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier dhe prodhimin e Energjisë”

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- **SPV:** “Integrated Technology Waste Treatment Fier Sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 3.72 miliardë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 30 Nëntor 2016
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 6 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Ndërtim



2.5.2. Performanca e projektit dhe lloji i financimit

Aktualisht projekti është në fazën e ndërtimit dhe disbursimet vazhdojnë sipas kontratës. Deri më tani janë realizuar 95% e punimeve civile. Problem ngelet instalimi i makinerive dhe pajisjeve elektromekanike si dhe lidhja me sistemin elektroenergjitik. Është planifikuar të rikuperohen mbetjet e qarkut Fier rreth 5400 ton mbetje në muaj.

Për këtë projekt është projektuar mbështetja buxhetore me vlerë prej 4.5 miliardë lekë përgjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit. Pagesat buxhetore kanë filluar në 2017, me kohëzgjatje 6 vjet (2016-2023). Pagesat faktike të 9-mujorit 2019 janë në masën rreth 564,6 milionë lekë, duke rezultuar me një realizim prej 75% përqind nga plani vjetor 2019 prej rreth 752.8 milionë lekë.

Tabela 10: Pagesat Buxhetore për projektin “Inceneratori i Fierit”

Viti	2018		2019		2020	2021
	Plan	Fakt	Plan	Fakt-9 mujor	Projektuar	Projektuar
Pagesat Buxhetore (në mijë lekë)	752,772	752,771	752,772	564,576	752,770	752,770


Për koncesionin e Inceneratorit të Fierit, treguesi kryesor për realizimin e nivelit të përmbushjes së shërbimit të ofruar është sasia e mbetjeve urbane të rikuperuara dhe të përdorura si lëndë djegëse për prodhimin e energjisë.

- Për vitin 2019, sipas kontratës parashikohet që sasia e mbetje urbane të rikuperuara të jetë 64.800 ton/vit, ose 5.400 ton/muaj. Deri në fund të periudhës 9-mujore nuk ka patur raportim mbi realizimin e treguesit të performancës pasi impianti është ende në proces ndërtimi.
- Sipas parashikimeve, ndërtimi dhe vënia në funksionim e impiantit do të përfundonte në muajin Shtator 2019. Por Autoriteti ka raportuar se janë realizuar 95% e punimeve civile. Problem mbetet instalimi i makinerive dhe pajisjeve elektromekanike si dhe lidhja me sistemin elektroenergjitik.

2.5.3. Risqet

Autoriteti ka raportuar në lidhje me risqet e kontratës sipas formatit të përcaktuar, duke specifikuar përcaktimin e palës që merr përsipër riskun, impaktin fiskal nëse është materializuar, probabilitetin e ndodhjes në të ardhmen dhe impaktin e pritshëm nëse ndodh. Sipas raportimeve, Autoriteti Kontraktues ka mbajtur riskun e qeverisjes, riskun politik dhe riskun e ndryshimeve ligjore, ndërsa partneri privat ka mbajtur riskun financiar, riskun e vendodhjes, riskun e operimit (menaxhimi i impiantit, menaxhimi i mbetjeve) dhe riskun e transferimit të asetëve. Ndërkohë risku i forcës madhore, risku i rinegocimit, risku i ndërprerjes së kontratës, risku i kërkesës dhe risku i ndërtimit janë ndarë mes të dyja palëve.

Figura 14: Alokimi i risqeve në kontratën e koncesionit/PPP “Inceneratori i Fierit”



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (2019)

❖ Sektori i Shëndetësisë

Në sektorin e shëndetësisë janë miratuar 4 kontrata koncesionare/PPP që kanë si Autoritet Kontraktues Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe kanë si qëllim ofrimin e një shërbimi sa më cilësor, më të shpejtë dhe efektiv në lidhje me shëndetin e qytetarëve.

2.6. Kontrata Koncesionare/PPP “Për shërbime të integruara për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, si dhe trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”

2.6.1. Përshkrimi i përgjithshëm i projektit

Ky projekt është propozim i kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i nënshkruar në vitin 2015 me shoqërinë koncesionare ‘Sani Service sh.p.k,’ dhe ka si qëllim menaxhimin e qendrës së sterilizimit, ofrimin e instrumenteve kirurgjikale sterile sipas setit të personalizuar, veshjet në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve mjekësore me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale ku do të ofrohet ky shërbim.

Projekti shtrihet në të gjitha spitalet universitare, rajonale dhe spitalet bashkiakë. Shërbimi kryhet pranë sallave kirurgjikale, ambienteve ku ka aktivitet kirurgjik, mikrokirurgjik, ambulator dhe urgjencat e spitaleve universitare dhe rajonale.

Ky partneritet ka synuar një menaxhim më të mirë të situatës së sallave operative në spitalet e vendit.

Zëvendësimi i skemës ekzistuese të pajisjeve dhe sterilizimit të instrumenteve kirurgjikale dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale ka patur si qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit për të ulur numrin e infeksioneve të marra nga pajisjet kirurgjikale.

2.6.2. Performanca e projektit dhe lloji i financimit

Në bazë të të dhënave të raportuara, lidhur me aktivitetin e financimit të kësaj kontrate, numri i ndërhyrjeve dhe vlera e rimbursuar e këtij shërbimi ka ardhur në rritje ndër vite.

Niveli i ndërhyrjeve i parashikuar në kontratë është 62.957 ndërhyrje ndërkohë që vetëm për vitin 2018 janë realizuar 117.000 ndërhyrje. Për vitin 2019 janë parashikuar 63.600 ndërhyrje dhe për periudhën Janar- Shtator janë realizuar 47,241 ndërhyrje, ose rreth 74 përqind e planit vjetor të parashikuar, pa përfshirë paketimet me avull, që për të njëjtën periudhë janë 50,849.

Kontrata Koncesionare “Për shërbime të integruara për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, si dhe trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- **SPV:** Sani Service sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 1.5 miliardë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 10 Dhjetor 2015
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 10 vite
- **Faza aktuale e projektit:** Operim



Pagesat për këtë kontratë realizohen sipas skemës (pay x use), prandaj tejkalimi në nivel vjetor i numrit të ndërhyrjeve të planifikuara sjell kosto shtesë për buxhetin e shtetit. Përveç kësaj, siç shihet, numri i rasteve të realizuara për 9 mujorin, është i përafërt me numrin e parashikuar të ndërhyrjeve, ndërsa vlera e realizuar është 1,253 milionë lekë. Ndër vite ka ndryshuar edhe pesha specifike e llojit të ndërhyrjeve të përdorura, sipas tabelës si më poshtë:

Tabela 11: Pesha specifike e llojit të ndërhyrjeve të përdorura

Viti	Ndërhyrje me kompleksitet të lartë	Ndërhyrje me kompleksitet të mesëm	Ndërhyrje me kompleksitet të ulët
2018	13.6%	25.0%	61.4%
9-mujori 2019	19.9%	37.9%	42.2%

Pagesat për 9-mujorin e vitit 2019 janë rreth 1.64 miliardë lekë ose rreth 85.7 përqind e planit të rishikuar vjetor të pagesave të parashikuara për vitin 2019. Ky realizim i lartë lidhet me pagesat e detyrimeve për tejkalimin e numrit të ndërhyrjeve gjatë vitit 2018 (610 milionë lekë).

Tabela 12: Pagesat Buxhetore për projektin “Setet Kirugjikale”

Viti	2018		2019		2020	2021
	Plan	Fakt	Plan	Fakt-9 mujor	Projektuar	Projektuar
Pagesat Buxhetore (në mijë lekë)	1,625,581	1,625,581	1,913,852	1,639,628	1,655,322	1,704,982

2.6.3. Risqet

Autoriteti ka raportuar në lidhje me risqet e kontratës sipas formatit të përcaktuar, duke specifikuar përcaktimin e palës që merr përsipër riskun, impaktin fiskal nëse është materializuar, probabilitetin e ndodhjes në të ardhmen dhe impaktin e pritshëm nëse ndodh. Tek pala private janë transferuar risku i projektimit, ndërtimit, i operimit dhe performancës, si dhe risku i transferimit të aseteve, ndërsa risku i ndryshimeve ligjore, risku material nga vendimet politike dhe risku financiar i janë alokuar palës publike. Ndërkohë janë ndarë mes palëve risku i lejeve dhe licencave, risku i kërkesës, risku i forcës madhore, risku i rinegocimit dhe risku i ndërprerjes së kontratës.

Figura 15: Alokimi i risqeve në kontratën e koncesionit/PPP “Setet Kirurgjikale”



Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2019)

Deri në momentin aktual të funksionimit të kontratës janë materializuar risqet e mëposhtme:

- Risku i Kërkesës** i cili ka rezultuar si pasojë e nevojave për instrumenta kirurgjikalë më shumë se sa parashikimi fillestar. Në lidhje me nivelin aktual të kërkesës për kontratat që kanë të parashikuar një minimum të garantuar kërkesë, MSHMS bën me dije se referuar kësaj kontrate rezulton se shërbimet objekt kontrate ofrohen sipas formulës pay per use.
- Risku i Rinegocimit** i cili ka rezultuar si pasojë e rritjes së numri të kërkesës mbi atë të parashikuar në kontratë dhe po punohet për arritjen e një zgjidhjeje efikase për të dyja palët, me qëllim realizimin e objektit të projektit.

2.7. Kontrata Koncesionare/PPP “Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë për grupmoshat 35-70”

2.7.1. Përshkrimi i përgjithshëm i projektit

Ky projekt është propozim i kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i nënshkruar në vitin 2015 me shoqërinë koncesionare “3P Life Logistic” dhe ka kohëzgjatje prej 10 vitesh.

Ky partneritet publik-privat ka si qëllim kontrollin mjekësor bazë që është një program kombëtar i cili synon depistimin e popullatës për faktorët e rrezikut dhe sëmundjet më të përhapura, me qëllim kujdesin për shëndetin, parandalimin e sëmundjeve dhe komplikacioneve, zbulimin e hershëm të çrregullimeve, mjekimin në fazat e hershme dhe përmirësimin e kulturës shëndetësore.

Kjo kontratë ka filluar të implementohet në datë 31.03.2015 dhe zbatimi i projektit ka ecur sipas afateve të përcaktuara në të. Në bazë të kësaj kontrate, shoqëria koncesionare ka marrë përsipër të ndërtojë, pajisë me aparaturat mjekësore të nevojshme, operojë dhe menaxhojë 20 laboratore.

Nëpërmjet këtij programi kontrolli bëhet e mundur që, për periudhën afatmesme në afatgjatë, të mund të zbulohen në kohë dhe të parandalohen sa më shumë të jetë e mundur sëmundje të cilat nëse nuk do të identifikoheshin në kohë, do të sillnin pasoja

të konsiderueshme për vetë njerëzit e prekur, por edhe kosto të konsiderueshme për trajtimin e tyre me shërbimet e nevojshme shëndetësore.

Ky shërbim përfitohet falas nga të gjithë shtetasit e grupmoshës 35-70 vjeç, me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

2.7.2. Performanca e projektit dhe lloji i financimit

Për këtë kontratë partneriteti publik privat në nivel vjetor janë parashikuar 475,000 përfitues të shërbimit, pra 39,583 raste në muaj. Rreziku i kërkesës do të jetë i lartë në rastin e këtij shërbimi pasi ky projekt nëpërmjet kësaj kontrate AK i garanton një mbështetje financiare koncesionarit deri në 475.000 kontrolle në vit.

Në bazë të të dhënave të raportuara, numri i përfituesve të këtij shërbimi ka ardhur në rritje ndër vite (shih tabela 13), duke shënuar 365,802 kontrolle për 9-mujorin e vitit 2019, ose 2.7% më shumë në krahasim me numrin e planifikuar për këtë periudhë.

Kontrata Koncesionare “Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë për grupmoshat 35-70”

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- **SPV:** 3P Life Logistic sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 172 milionë Lekë
- **Data e fillimit të kontratës:** 07.01.2015
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 10 vite
- **Faza aktuale e projektit:** Operim



Tabela 13: Numri i Përfituesve të kontrollit mjekësor bazë Check-Up

Viti	2015	2016	2017	2018	09 mujori 2019
Nr.i Përfituesve	244,420	329,555	316,601	428,891	365,802

Pagesat faktike për 9-mujorin e vitit 2019 janë rreth 657 milionë lekë, duke rezultuar me një realizim prej 75% të planit vjetor 2019. Pagesat e planifikuara për vitin 2019 mbeten në të njëjtin nivel prej 876 milionë lekë.


Tabela 14: Pagesat Buxhetore për projektin “Kontrolli Mjekësor Bazë Check-Up ”

Viti	2018		2019		2020	2021
	Plan	Fakt	Plan	Fakt-9 mujor	Projektuar	Projektuar
Pagesat Buxhetore (në mijë lekë)	876,083	876,083	876,083	657,062	876,083	876,083

2.7.3. Risqet

Autoriteti ka raportuar në lidhje me risqet e kontratës sipas formatit të përcaktuar, duke specifikuar përcaktimin e palës që merr përsipër riskun, impaktin fiskal nëse është materializuar, probabilitetin e ndodhjes në të ardhmen dhe impaktin e pritshëm nëse ndodh. Në lidhje me risqet që rrjedhin nga zbatimi i kontratës koncesionare, tek pala private janë transferuar risku i ndërtimit, risku i operimit dhe performancës, risku i transferimit të asetëve, ndërsa risku i ndryshimeve ligjore, risku material nga vendimet politike, risku financiar i janë alokuar palës publike. Ndërkohë janë ndarë mes palëve risku i kërkesës, risku i forcës madhore, risku i rinegocimit, risku i ndërprerjes së kontratës dhe risku i lejeve dhe liçencave

Figura 16: Alokimi i risqeve në kontratën e koncesionit/PPP “Kontrolli Mjekësor Bazë Check-Up”



Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2019)

Lidhur me riskun e kërkesës raportohet se Autoriteti Kontraktues ka ndërmarrë fushata sensibilizuese për popullatën, si dhe ka ndryshuar kontratën në lidhje me moshën e përfituesve duke zgjeruar fashën e mbulimit nga 40-65 vjeç të cilën e ka bërë 35-70 vjeç.

❖ Sektori Energjitikës

Gjatë viteve 2005-2013, në kuadër të privatizimit të HEC-eve vendore një numër hidrocentralësh të vegjël u privatizuan dhe disa të tjerë iu dhanë kompanive të huaja dhe vendase përmes kontratave koncesionare të tipit ROT, BOT dhe BOO. Qëllimi i këtyre kontratave ishte rehabilitimin i HEC-eve ekzistuese, operimi i tyre dhe më pas transferimi tek shteti. Aktualisht janë 186 kontrata koncesionare në fushën e hidroenergjisë. Dy kontratat me të mëdha koncesionare të miratuara janë ‘*Hidrocentrali i Ashtës*’ dhe ‘*Kaskada e hidrocentralit të Devollit*’, të cilat janë përzgjedhur për tu trajtuar në këtë raport.

2.8. Kontrata Koncesionare/PPP “Për projektimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Hidrocentralit Ashta”

2.8.1. Prezantim i përgjithshëm i projektit

Hidrocentrali i Ashtës është i pozicionuar në veri të Shqipërisë, afër Shkodrës.

HEC-i përmirëson sigurinë e furnizimit në Shqipëri dhe gjithashtu ndihmon në reduktimin e varësisë së vendit nga importet e energjisë elektrike. HEC-i i Ashtës është projektuar të mundësojë një prodhim efikas të energjisë, në përputhje me mjedisin, duke mos lëshuar mbetje. Në fund të periudhës 35-vjeçare të koncesionit HEC-i do t’i kthehet shtetit shqiptar.


HEC-i është i ndarë në dy stacione: Ashta 1 dhe Ashta 2. Ashta 1 gjeneron e para elektricitet. Në fund të kanalit lidhës 5 km të gjatë në afërsi të fshatit të Ashtës, elektriciteti do të gjenerohet sërish, por këtë herë në Ashta 2.

2.8.2. Performanca e projektit dhe lloji i financimit

Realizimi i investimit të këtij projekti është finalizuar brenda afateve kohore të parashikuara në marrëveshjen mes palëve, përkatësisht ndërtimi është realizuar në periudhën kohore 2010-2012. Për këtë projekt është nënshkruar fillimisht me KESH më pas me OSHEE, një marrëveshje për shitjen e energjisë elektrike. Kjo marrëveshje është nënshkruar në 2016, pas ndryshimeve ligjore dhe nënligjore në sektorin e energjisë elektrike, ku detyrimi për blerjen e energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi kaloi nga KESH sh.a. tek OSHEE sh.a. (pika G e kësaj marrëveshje).

Kontrata Koncesionare “Për projektimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Hidrocentralit Ashta ”

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- **SPV:** “Energji Ashta” sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 19,5 miliardë Lekë
- **Data e fillimit të kontratës:** 22 Tetor 2008
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 35 vite
- **Faza aktuale e projektit:** Operim



Kjo marrëveshje vjen në vijim të marrëveshjes së nënshkruar më datë 28.03.2013 (pika F), dhe do të jetë e vlefshme për një periudhë 15 vjeçare nga momenti i nënshkrimit (28.03.20128) (pika E).

Aktualisht ky projekt është në fazën e operimit që prej vitit 2013. Prodhimi i energjisë elektrike nga HEC Ashta 1, 2, bëhet me planifikim dhe sipas regjimit të shkarkimit nga KESH sh.a. Në bazë të marrëveshjes koncesionare, energjia e prodhuar nga Hidrocentral Ashta 1, 2 nuk duhet të jetë më pak se 165,000 GWh/vit, ndërkohë ecuria e sasisë së energjisë së prodhuar nga shoqëria koncesionare ndër vite është si më poshtë:


Tabela 15: Sasia e energjisë së prodhuar (në GWh/Vit)

Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018	9-mujori 2019
Sasia e energjisë	211,190	200,992	235,604	276,604	174,526	298,107	132,897

2.8.3. Risqet

Autoriteti ka raportuar në lidhje me risqet e kontratës sipas formatit të përcaktuar, duke specifikuar përcaktimin e palës që merr përsipër riskun, impaktin fiskal nëse është materializuar, probabilitetin e ndodhjes në të ardhmen dhe impaktin e pritshëm nëse ndodh. Në lidhje me risqet që rrjedhin nga zbatimi i kontratës koncesionare, tek pala private janë transferuar: risku i ndërtimit, risku financiar, risku i operimit dhe performancës dhe risku i transferimit të asetëve, ndërsa risku i qeverisjes, risku i ndryshimeve ligjore dhe risku material nga vendimet politike i janë alokuar palës publike. Ndërkohë janë ndarë mes palëve risku i forcës madhore, risku i rinegocimit dhe risku i ndërprerjes së kontratës.

Figura 17: Alokimi i risqeve në kontratën e koncesionit/PPP “Hidrocentrali Ashta”



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (2019)

Gjatë zbatimit të kontratës nuk ka patur materializim të risqeve, dhe aktualisht Autoriteti përgjegjës për monitorimin e kësaj kontrate ka raportuar probabilitet të ulët të ndodhjes së risqeve

2.9. Kontrata Koncesionare/PPP “Për projektimin financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll”

2.9.1. Prezantim i përgjithshëm i projektit

Kjo kontratë koncesionare/PPP është e tipit BOOT dhe është nënshkruar mes MIE, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues dhe bashkë-koncesionarëve EVN AG, Statkraft AS dhe Devoll Hydropower sh.a, dhe ka si objekt planifikimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e tre njësiteve prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit, si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

Ky projekt synon ndërtimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin në fund tek Autoriteti Kontraktues të hidrocentraleve HEC-i Banje dhe HEC-i Moglicë . Në këtë kontratë koncesioni është bërë një shtesë më datë 18.12.2014 “Për projektimin dhe ndërtimin e infrastrukturës zëvendësuese të Moglicës”, me anën e së cilës koncesionari ka marrë përsipër të projektojë, ndërtojë infrastrukturën zëvendësuese kundrejt një kompensimi nga buxheti i shtetit. Vlera e këtij kompensimi është në shumën 7 miliardë lekë dhe shlyerja e saj ka përfunduar në vitin 2019.

Kontrata Koncesionare “Për projektimin financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll”

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- **SPV:** Devoll Hydropower sh.a
- **Vlera e Investimit:** 130 miliardë Lekë
- **Data e fillimit të kontratës:** 17.03.2009
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 35 vite
- **Faza aktuale e projektit:** Operim



2.9.2. Performanca e projektit dhe lloji i financimit

Që nga viti 2013 deri në 9-mujorin e vitit 2019 është realizuar 93.6% e vlerës totale të investimit. Aktualisht është në fazën e prodhimit vetëm HEC Banja. Referuar kontratës së koncesionit/PPP shteti shqiptar nuk e ka detyrim blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria koncesionare Devoll Hydropower sh.a. Në bazë të marrëveshjes koncesionare, energjia e prodhuar nga Hec Banja nuk duhet të jetë më pak se 255,000 GWh/vit, ndërkohë ecuria e sasisë së energjisë së prodhuar nga shoqëria koncesionare që nga viti i prodhimit është si më poshtë:

Tabela 16: Sasia e energjisë së prodhuar (në GWh/Vit)


Viti	2017	2018	9-mujori 2019
Sasia e energjisë	140,866	292,561	132,699

Ndërkohë, punimet e ndërtimit të hidrocentralit Moglica janë përfunduar, por ky hidrocentral nuk është ende në fazë prodhimi, për arsye se është në fazën e mbushjes së rezervuarit (ky hidrocentral është hidrocentral me digë). Në bazë të marrëveshjes koncesionare, energjia e prodhuar nga HEC Moglica nuk duhet të jetë më pak se 534,000 GWh/vit.

2.9.3. Risqet

Autoriteti ka raportuar në lidhje me risqet e kontratës sipas formatit të përcaktuar, duke specifikuar përcaktimin e palës që merr përsipër riskun, impaktin fiskal nëse është materializuar, probabilitetin e ndodhjes në të ardhmen dhe impaktin e pritshëm nëse ndodh. Në lidhje me risqet që rrjedhin nga zbatimi i kontratës koncesionare, tek pala private janë transferuar risku i ndërtimit, risku financiar, risku i operimit dhe performancës dhe risku i transferimit të aseteve, ndërsa risku i qeverisjes, risku i ndryshimeve ligjore dhe risku material nga vendimet politike i janë alokuar palës publike. Ndërkohë janë ndarë mes palëve risku i forcës madhore, risku i rinegocimit dhe risku i ndërprerjes së kontratës.

Figura 18: Alokimi i risqeve në kontratën e koncesionit/PPP “Kaskada e Devollit”



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (2019)

Gjatë zbatimit të kontratës nuk ka patur materializim të risqeve, dhe aktualisht Autoriteti përgjegjës për monitorimin e kësaj kontrate ka raportuar probabilitetet të ulët të ndodhjes së risqeve.

❖ *Sektori i kontrollit fiskal dhe sigurisë në kufi*

Siguria në kufi është një nga sfidat e sigurisë më komplekse dhe kritike që qeveritë hasin në ditët e sotme. Meqenëse mundëson hyrjen dhe daljen e njerëzve dhe mallrave, kufiri mbetet kritik për prosperitetin e shteteve. Përmirësimet në monitorimin e kufirit kanë treguar se mund të japin përfitime të ndjeshme për shtetet, jo vetëm për të rritur nivelin e sigurisë, por edhe duke krijuar një mjedis më miqësor tregtar nëpërmjet rritjes së të ardhurave doganore, duke forcuar ekonominë e shtetit. Në këtë kuadër, nga Qeveria Shqiptare është dhënë me koncesion shërbimi i skanimit të kontenerëve dhe aktualisht procesi i skanimit kryhet në Degët Doganore Kapshticë, Kakavijë, Morinë, Durrës dhe Qafë Thanë.¹¹ Më poshtë, jepet një përshkrim më i detajuar në lidhje me këtë kontratë koncesioni.

2.10. Kontrata Koncesionare/PPP “Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të konteinereve e automjeteve të tjera në RSH”

2.10.1. Përshkrim i përgjithshëm i projektit

Ky projekt koncesionar është me mbështetje buxhetore dhe është realizuar nga bashkëpunimi i Ministrisë së Financave në cilësinë e Autoritetit Kontraktues dhe shoqërisë koncesionare “S2 Albania”, me një kohëzgjatje prej 15 vitesh.

Objekti i këtij projekti Koncesion/PPP është shmangia e nënraportimeve të deklarave doganore për efekt të keqklasifikimeve të kodeve, të mallrave, për marrjen e detyrimeve doganore ekzaktësisht për produkte që zhdoganohen, por gjithashtu ka si qëllim edhe përforcimin e sigurisë kombëtare, sigurimin e kufijve nga parandalimi i kontrabandës, kryesisht të produkteve të akcizës, të lëndëve narkotike, të produkteve të dëmshme, të armëve, të municioneve, etj.

Kjo kontratë koncesioni është miratuar fillimisht me anë të Ligjit Nr.123/2013 dhe është ndryshuar më pas me Ligjin Nr.74/2015, për shkak të kundërshtimeve të hasura nga bizneset në vend, pasi vlera e pagesës për deklaratat doganore implikonte kosto të larta për këto të fundit.

Ndryshimet e bëra konsistojnë në ndryshimin e vlerës së tarifës së skanimit për deklaratat doganore. Nëse para ndryshimeve tarifa për çdo deklaratë doganore të skanuar ishte 39 Euro, tashmë me ndryshimin ligjor

Kontrata Koncesionare “Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të konteinereve e automjeteve të tjera në RSH”

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- **SPV:** S2 Albania sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 2.83 miliardë Lekë
- **Data e fillimit të kontratës:** Nënshkruar 10 prilli 2013, kontrata e rinegociuar më 28 Prill 2015
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 15 vite



¹¹ <http://www.dogana.gov.al/c/169/185/266/skanimi-ne-dogane>

tarifa e skanimit u vendos të jetë 5 Euro për deklaratat doganore nën ose të barabarta me 1000 Euro dhe 22 Euro për deklaratat doganore mbi 1000 Euro.

Pas ndryshimeve, të ardhurat e shoqërisë koncesionare janë siguruar nga pagesat e bëra nga Autoriteti Kontraktues, i cili i paguan një tarifë prej 2,260,000 Euro për Shërbimet e Caktuara për çdo Vend, tarifë e cila do rritet çdo vit me koeficient 1.03. Nga kjo tarifë do të zbritet tarifa mujore koncesionare prej 2 përqind e cila duhet t'i paguhet Autoritetit nga shoqëria koncesionare. Diferenca e mbetur përbën Tarifën e Shërbimit të Vendit, e cila do paguhet në bazë mujore.

Në parashikimin e bërë nga koncesionari në vitin 2013, të ardhurat vjetore bruto llogariteshin në vlerën 17.6 milion Euro. Mënyra e grumbullimit të këtyre të ardhurave ishte përcaktuar nëpërmjet mbledhjes së çmimit të skanimit për çdo deklaratë doganore (pra një përlllogaritje e thjeshtë midis numrit të deklarave doganore të skanuara dhe çmimit për njësi). Me ndryshimet e vitit 2015, përfitues i tarifës së skanimit të deklarave doganore është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Koncesionari përfiton gjatë periudhës së kontratës së koncesionit një tarifë bruto mesatarisht prej 13.5 milion Euro në vit (për 5 Vende Skanimi).

Nëpërmjet këtyre ndryshimeve ligjore të kryera në kontratën koncesionare të Shërbimit të Skanimit në Dogana, Ministria e Financave ka synuar që të minimizojë në maksimum kostot e biznesit që rezultojnë tepër të larta për skanimin e konteinerëve të mallrave të importuara në doganë.

Vlen të theksohet se në përfundim të këtij koncesioni, Shërbimit Doganor i kalohet në pronësi sistemi i skanerave si dhe të tjera pajisje që lidhen me shërbimin e skanimit të konteinerëve të vendosura në pikat doganore për të cilin në kontratë nuk është shprehur nëse ky kalim i aseteve do të bëhet i pashoqëruar me detyrime të mbartura.

2.10.2. Performanca e projektit dhe lloji i financimit

Aktualisht projekti është në fazën e operimit. Shërbimi i skanimit në Dogana ka mundur uljen progresive të evazionit fiskal si dhe nëpërmjet këtij shërbimi janë evidentuar në kohë transportimi i lëndëve dhe substancave të ndaluara me ligj (lëndë narkotike, mbetje radioaktive etj.)

Meqënëse kjo kontratë koncesionare/PPP është me mbështetje buxhetore, në tabelën 17 janë dhënë vlerat e pagesave nga buxheti i shtetit të realizuara për vitin 2018 dhe të planifikuara për vitet 2019-2021. Për 9-mujorin e parë të vitit 2019 financimi nga buxheti i shtetit ka qënë në vlerën rreth 1,1 miliardë lekë nga rreth 1.5 miliardë lekë të planifikuara për vitin 2019, duke rezultuar me një realizim prej 73.9 përqind të planit vjetor.

Tabela 17: Pagesat buxhetore për projektin “Skanimi i Doganave”

Viti	2018		2019		2020	2021
	Plan	Fakt	Plan	Fakt-9 mujor	Projektuar	Projektuar
Pagesat Buxhetore (në mijë lekë)	1,525,580	1,525,579	1,534,299	1,133,730	1,540,896	1,587,123

Tregues performance për koncesionin e Skanimit në Dogana, është raportuar disponueshmëria e skanerit (pra gatishmëria për të matur nivelin e përmbushjes së shërbimit të ofruar). Për vitin 2019 ky tregues është planifikuar të jetë jo më pak se 93.7 përqind për çdo muaj.

Në lidhje me numrin e kontenierëve që kalojnë në doganë për 9 mujorin e vitit 2019 janë shënuar 31,942 të tillë, ndërsa numri i atyre që janë skanuar është 10,318. Referuar numrit të kontenierëve që skanohen në doganat Kapshticë, Morinë, Qafë Thanë dhe Kakavijë, skanohen të gjithë kontenierët që kalojnë nëpërmjet këtyre pikave kufitare, ndërsa në Doganën e Durrësit skanimi i kontenierëve bëhet mbi bazën e profileve të riskut- natyrës së mallit, origjinës etj.

Nga të dhënat e gjeneruara nga sistemi i skanimit dhe mbikëqyrur rregullisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave numri i skanimeve të kryera ka patur tendencë rritëse, konkretisht:

Tabela 18: Numri i skanimeve ndër vite

Viti	2015	2016	2017	2018	9-mujori 2019
Nr.i skanimeve	14,655	169,528	226,948	272,576	198,252


Nëpërmjet këtij shërbimi janë evidentuar në kohë transportimi i lëndëve dhe substancave të ndaluara me ligj (lëndë narkotike, mbetje radioactive etj.), kontrabanda e produkteve farmaceutike, mallra kontrabandë, trafikim i njerëzve, pastrim parash etj. Për 9-mujorin e 2019, nga skanimi në doganat e vendit janë evidentuar në total 24 raste të tilla.

“S2 Albania” sh.p.k ka investuar në ndërtimin e Qendrës Operacionale, e cila mundëson analizën e imazheve nga zyra qëndrore. CertScani është platforma që bën të mundur ‘zgjidhjen e integruar’ nga më të avancuarat në nivel global në këtë fushë. Është bërë lidhja me fibër optike e të gjitha pikave të operimit (skanerave) me qendrën dhe kjo do të bëhet plotësisht operacionale në fillim të vitit 2020.

2.10.3. Risqet

Autoriteti ka raportuar në lidhje me risqet e kontratës sipas formatit të përcaktuar, duke specifikuar përcaktimin e palës që merr përsipër riskun, impaktin fiskal nëse është materializuar, probabilitetin e ndodhjes në të ardhmen dhe impaktin e pritshëm nëse ndodh.

Figura 19: Alokimi i risqeve në kontratën e koncesionit/PPP “Skanimi i Doganave”



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Lidhur me risqet aktualisht është aktivizuar risku i rinegocimit të kontratës, pasi nga Komisioni për Sigurinë Kombëtare është propozuar shtimi i një vendi të ri skanimi, konkretisht në doganën e Hanit të Hotit. Në këtë kuadër Autoriteti do të bëjë përpjekjet më të mira për të realizuar zbatimin e objektit të kësaj kontrate.

3. Lista e Koncesioneve/PPP të miratuara

Në tabelën 19 është paraqitur lista e kontratave koncesionare totale të publikuara në Regjistrin Publik e Koncesioneve në faqen e ATRAKO-s (2019), sipas raportimeve të Autoriteteve Kontraktuese pranë kësaj Agjencie. Në këtë listë nuk janë përfshirë dy kontratat e koncesionit/Partneritetit Publik Privat në fushën e infrastrukturës rrugore dhe konkretisht:

1. Kontrata e koncesionit/PPP “Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Milot–Balltren”
2. Kontrata e koncesionit/PPP “Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës “Porti i Jahteve–By Pass Orikum -Dukat (Ura e Shën Elizës)”

Këto dy kontrata janë miratuar me ligj të veçantë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë në datën 18.07.2019, por sipas raportimit të Agjencisë për Trajtimin të Koncesioneve, Autoriteti Kontraktues ende nuk i ka përcjellë për publikim këto kontrata në Regjistrin Elektronik të Koncesioneve/PPP.

Tabela 19: Lista e kontratave koncesionare/PPP

Nr.	Objekti i kontratës	Vlera e investimit në mijë lekë
1	Për rehabilitimin, operimin transferimin e Aeroportit të Kukësit	987,925
2	Për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës.	1,284,410
3	Për përmirësimin e infrastrukturës Arsimore në Bashkinë Tiranë	2,364,096
4	Për dhënien me koncesion të shërbimit të pastrimit, grumbullimit, transportimit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane për Qytetin Kamëz.	1,350,000
5	Për ndertimin, operimin dhe transferimin e Hec Kukur	304,604
6	Për ndertimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Bushtrica 3	559,309
7	Për përmirësimin, ndertimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit	26,504,000
8	Për ndërtimin e Hidrocentraleve mbi Lumin Shalë	11,239,204
9	Për ndertimin e Hidrocentralit Veleshicë	927,928
10	Për ndërtimin e Hidrocentralit Kalivaç	16,913,853
11	Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë për grupmoshat 40-65 vjeç	172,020
12	Për dhënien me koncesion të disa shërbimeve detare	238,374
13	Per ndertim landfillit inceneratorit dhe rehabilitimin e venddepozimeve ekzistuese Tirane dhe prodhimin e energjise elektrike.	17,121,152
14	Ndërtimi, operimi dhe transferimi Hidrocentraleve mbi Lumin Devoll, Infrastruktura zëvendësuese	7,000,000
15	Projektimi, financimi ndertimin, operimi, mirembajtja dhe transferimi i Hidrocentralit ne Lumin Devoll	130,000,000
16	Ndertimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Stojan	124,334
17	Ndërtimin, operimin, transferimin e Hidrocentralit Guri i Bardhë	800,908
18	Për dhënien me koncesion të prodhimit të kripës Nartë, Vlorë	1,400,000
19	Për Dhënien me Koncesion të Rregjistrin te Barreve Siguruese	35,692
20	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Lunik	786,900
21	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Bushtrica 1	506,147
22	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve mbi lumin Shushicë	2,433,789

23	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Grabovë 2	1,486,571
24	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Shutri 1, Shutri 2	136,784
25	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve të Lusës	621,368
26	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Përroin Sheja e Librazhdit	492,776
27	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Malla	176,321
28	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Blaç	44,000
29	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Malind	294,085
30	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Selca 2, Mesmal	269,981
31	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Batra 1, Batra 2, Batra 3	369,786
32	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Zalli i Qarishtes	5,273,943
33	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Truen	192,560
34	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Gojan, Gjegan, Peshqesh, Ura e Fanit, Fangu	16,322,956
35	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Zall Xhuxhe 1, Zhall Xhuxhe 2	85,780
36	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Sekë	1,177,888
37	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve mbi lumin Gostimë, Egnatia Shushicë	7,806,058
38	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Stavec	870,315
39	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Rapun 1, Rapun 2	749,448
40	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Darsi 1, Darsi 2, Darsi 3, Darsi 4	1,230,441
41	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve ne lumin e Shalës	18,915,951
42	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Valbona	274,205
43	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve në Rrjedhën e lumit Shkumbin, Qukës	6,249,093
44	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve mbi përroin Zalli i Lunikut Librazhd	1,702,149
45	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Topçias	128,221
46	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Gjoni, Blishta, Klosi, Domi, Luçi, Shoshaj, Zenishti, Burreli	4,069,596
47	Ndërtim, operim, transferim e 5 Hidrocentraleve në rrjedhën e lumit Shkumbin	847,000
48	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve mbi lumin Valbonë rrethi Tropojë.	7,327,423
49	Për ndërtimin e administrimin e Impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë	3,727,189
50	Për ndërtimin, operim dhe transferim të Hidrocentraleve Veleshica 1, 2, 3, 4, 5, 6 Sillove dhe Bjeshke	3,254,323
51	Për ndërtimin operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Peshku	188,056
52	Ndërtim, shfrytëzim dhe transferim të Hidrocentraleve Lura 1, 2 dhe 3	1,300,178
53	Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve Kaskada e Luses	743,776
54	Ndërtim, operim dhe transferim të Hidrocentraleve në Kaskadën e Osumit	32,377,517
55	Ndërtim, operim dhe transferim Hec Holta Kabash dhe Holta Porocan	500,000
56	Ndërtim, operim dhe transferim i Hidrocentralit Dragobia	2,404,858
57	Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Begaj	2,794,366
58	Ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Hidrocentralit të ri në Ashta	19,520,000
59	Ndërtimi, përmirësimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e Autostradës Milot-Morinë	5,348,534
60	Prodhimi dhe shpërndarja e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike.	0
61	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Cangonj	62,650
62	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Iballe 1, 2, Sapaç 1, 2, Berisha dhe Liqeni, Rrethi Pukë	1,572,169
63	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Arrez 1, Arrez 2, Arrez 3 dhe Arrez 4	295,860
64	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Kasollet e Selcës	526,318
65	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Steblevë	159,680

66	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Suha 2	360,000
67	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Bënçë dhe Tepelenë	675,221
68	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Meshanik dhe Guvë	216,153
69	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Çaje, Reke, Livadhe, Shkinak, Lapaj 2, Bushtrica 1, Bushtrica 2 dhe Bushtrica 3	3,673,402
70	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve në Pellgun Ujëmbledhës të Zallit të Bulqizes/Vajkal- Rrethi Bulqize	587,564
71	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Myhejani 1, Myhejani 2, Myhejani 3	577,625
72	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Backa 1, Backa 2, Backa A, Backa B, Backa C	1,156,809
73	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Lefter 1, Lefter 2A, Lefter 2B, Lefter 3 (Zgjidhur me marrëveshjen me nr 2357 Rep nr 1173/3 Kol datë 06.11.2018)	208,659
74	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Ballenjë	138,315
75	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Kaçinar	315,219
76	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Lumzi	1,725,593
77	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Plepi, në Përroin e Plepit, Komuna Okshun, Rrethi Diber	86,818
78	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Vendresh, në Pellgun ujëmbledhës Përroi Vendreshes, Komuna Vendresh, Rrethi Skrapar	37,250
79	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve mbi Lumin Gjader	1,592,691
80	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Kaskada e Hec-eve të Hotolishtit	567,860
81	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Dobrenje-Tomorrice, në Përroin e Hijes, Skrapar	106,780
82	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Potam	291,900
83	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Guri I Kuq 1/1 dhe Guri I Kuq 1/2	136,964
84	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Denas	936,000
85	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Vokopola 1, Vokopola 2 dhe Vokopola 3	497,258
86	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Shengjon, Komuna Fan, Rrethi Mirditë	101,242
87	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Skatinë	129,542
88	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Shkopet 2 dhe Shkopet 3	2,273,384
89	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Bregu i Madh	128,136
90	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve GavranI dhe Gavran	164,333
91	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Bershi-Klos	250,549
92	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Shengjun	349,865
93	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Bigas dhe Veleshnje	42,420
94	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Nishan	212,520
95	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Quku 1 dhe Quku 2	150,895
96	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Shutri	139,667
97	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Vernik 1, Vernik 2, Vernik 3 dhe Vernik 4	971,365
98	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Lajthia, Kolesjan, Domaj	123,761
99	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Kryezi 3, Kryezi 4 dhe Kryezi 5	131,064
100	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Shpella Poshtë II dhe Shpella Poshtë III	144,560
101	Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Tuçep 2	166,000
102	Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve mbi Lumin Curraj, Rrethi Tropojë	13,728,387
103	Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Suha-1	3,181,563
104	Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Spathare	80,071
105	Ndërtim, operim, trenasferim i hidrocentralit Labinot Fushë	347,706

106	Ndërtim, operim dhe transferim, i Hidrocentraleve, Prishtë 1, Prishtë 2,	329,257
107	Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve në Pellgun Ujëmbledhës të Shmilit dhe Zallit të Gjurait, Rrethi Librazhd	1,165,964
108	Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Lingjaca	149,525
109	Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve Gjuraj, Kashec, Ragam dhe Lepurushe	780,000
110	Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve, Cemerica 1, Cemerica 2 dhe Cemerica 3	300,674
111	Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Egnatia	321,957
112	Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve VRANISHT, STROPAN, GRAPSH-ZICISHT dhe HOCISHT	92,549
113	Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit VILIQ	199,260
114	Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit KALIVAR	465,326
115	Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit ARSTI	225,125
116	Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit QYTEZË	27,700
117	Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve mbi Përroin Ujëmbledhës të Përroit të Zhejës	61,916
118	Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve mbi Lumin SETA	1,400,806
119	Ndërtim, operim dhe transferim I hidrocentraleve FLETI 1, FLETI 2, FLETI A dhe FLETI B	815,964
120	Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentralit RUNJA	351,245
121	Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve GERMANI 1, 2, 3, 4 dhe 5	348,238
122	Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve PRELLE 1 dhe PRELLE 2	1,512,586
123	Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentralit LLËNGË	252,560
124	Ndërtim, operim dhe transferim e hidrocentraleve SHEBA 1, SHEBA 2, SHEBA 3 dhe SHEBA 4	416,000
125	Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve të Lashkizës	322,691
126	Ndërtim, operim dhe transferimin e hidrocentraleve ZAJE, TUJAN, XHAFERAJ, KOLLOVOZ, NOVOSEJË, MËSHTEKËN	223,087
127	Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve RAPUN 3, RAPUN 3A dhe RAPUN 4	790,361
128	Rehabilitimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit DOMAJ, Has	12,370
129	Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve mbi Lumin Kardhiq	1,041,453
130	Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve TREBINJA 1, TREBINJA 2, POTGOZHAN, KALIVAÇ dhe DUNICE	175,586
131	Ndërtim, operim dhe transferimin e hidrocentralit ZEREC	120,312
132	Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve ARRËZ, SHËNDELLI, SOTIRE, PODE, MESARE, URA, RAJAN 2, RADON, DEDOVE, PESHTAN, OSNATI DHE GRADISHT	837,404
133	Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve KUKUR 1, 2, 3, 4 dhe 5	4,547,551
134	Ndërtimi operimi dhe transferimi i hidrocentraleve Sotirë, Sotirë 2	144,555
135	Ndërtimi operimi dhe transferimi i hidrocentraleve Gur Shpat 1, Gur Shpat 2	176,739
136	Ndërtimi operimi dhe transferimi i hidrocentralit Mollaj	79,700
137	Ndërtimi operimi dhe transferimi i hidrocentralit Lapaj	1,453,500
138	Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentraleve të kaskadës së lumit Dardhë.	907,956
139	Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Lena 1, Lena 2, Lena 2-A	311,332
140	Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentraleve Lenie, Shalës, Strelcë	354,282

141	Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Picar 1	35,456
142	Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Qafëzezë	51,955
143	Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Verbë - Selcë.	285,214
144	Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferim te hidrocentraleve Murdhar 1 dhe Murdhar 2	501,412
145	"Dhënie me Koncesion/Partneritet Publik Privat të Shërbimit të Sistemit dhe Menaxhimit të Parkimit në Qytetin e Vlorës	-
146	Ndërtimi, Operimi, Transferim i parkimit nëntokësor në parkun "Rinia", Tiranë	1,937,933
147	Ndërtim, Operim, Transferim i hidrocentralit Poçem	14,134,724
148	Kontratë Koncesioni për kultivimin e ullirit deri në 1000 ha, Kavajë	1,906,500
149	Menaxhimi dhe zhvillimi teknologjik i prodhimit të fidanëve pyjor/arror në Fidanishten Shtetërore të Cërrikut, Elbasan	49,660
150	Ndërtimi dhe administrimi i impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të qarkut Elbasan	3,028,104
151	Shfrytëzimi i Burimit ujor "Sasaj, Bunec", Sarandë	503,713
152	Ndërtim, Shfrytëzim dhe Transferim në pronësi të shtetit, të Portit të Jahteve Shëngjin	730,338
153	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Nishova 1, 2	89,684
154	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Vlushë	1,718,835
155	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Përroi i Trebishit, Bulqizë	209,336
156	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Çekrezë 1, 2	123,858
157	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Radovë	188,000
158	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Hurdhasi 1, 2, 3	200,000
159	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Stravaj	503,529
160	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Shutinë	115,000
161	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Kacni	133,121
162	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Strelca 1, Strelca 2, Strelca 3	1,084,000
163	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Progonat, Lekdush - Bënçë e Sipërme (Zgjidhur më 02.03.2018).	929,147
164	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Peqin	521,573
165	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Nicë	49,800
166	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Vërtop	283,950
167	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Shtika 1,2,3,4	87,570
168	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Koxheraj	102,963
169	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Perrollaj	51,435
170	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Driza	151,000
171	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Lumi Zalli i Okshtunit	4,443,351
172	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Qarr Kaltanj	273,893
173	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Lumi Treskës	656,545
174	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Kozel, Helmes 1 dhe Helmes 2	108,000
175	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Ujanik 2	134,550
176	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Bisak	50,618
177	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Bistrica 3 dhe 4	756,400
178	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Lengarica 1 dhe 2	1,980,904
179	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Gostivisht, Langarica3, Ura e Dashit	309,816
180	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Ostren i Vogël	46,871
181	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Shemri dhe Mgulle	69,027
182	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Kryezi dhe Kryezi i Epërm	50,419
183	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Sllabinjë	1,290,117

184	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Martanesh	857,862
185	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Belesova 1 dhe 2	46,315
186	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Borje, Oreshkë, Cernalevë, Cernalevë 1	830,097
187	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit koka 1	392,862
188	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Klos	96,422
189	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Bishnica 1 dhe 2	250,000
190	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Pobreg	995,035
191	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Selishtë	120,000
192	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Orgjost i Ri; Bele 1, 2; Topojan 1,2	3,565,745
193	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Dobjot i Madh, Arrëz, Miras, Menkulas, Bracen, Kuç.	124,254
194	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Liqenet, Maja e Madhe, Zanore, Dragostunjë, Frari, Hotolisht, Ura	424,081
195	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Zerec 1,2	199,921
196	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Gomsiqe 1,2,3,4 (Zgjidhur me marrëveshjen me nr 242 Rep, nr 1186/1 Kol datë 16.11.2018)	2,149,411
197	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Thanë, Mollas	1,042,888
198	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Kabash 1 dhe 2	671,000
199	Infrastruktura Hekurudhore Fier-Ballsh, Fier-Vlorë	2,431,918
200	Projektim, financim, rehabilitim, testim, shfrytëzim dhe mirembajtje të Qendrave të Kontrollit Teknik të mjeteve.	561,003
201	Menaxhimi, Operimi, Mirembajtja, Përmiresimi teknik dhe Adaptimi i terminalit të trageteve dhe krocerave Durrës.	581,387
202	Kryerja e shërbimit të rimorkimit të anijeve, Shërbimi i Transportit, Transportimi i Ekuipazheve të anijeve, Operacionet e ngarkim-shkarkimit.	1,200,000
203	Operimi, Ndërtimi, Mirëmbajtja, Përmiresimi Teknik dhe Adaptimi i Terminalit Lindor Durrës.	2,069,372
204	Ndërtimi, Shfrytëzimi dhe Transferimi të portit të tipit MBM, Porto Romano, Durrës	1,280,814
205	Financimi, Projektimi, Ndërtimi, Vënia në Punë, Administrimi, Mirëmbajtja dhe Transferimin e Hidrocentraleve "Shkallë", "Cerrujë", "Plesha", "Bejni 1", "Bejni 2", "Klos".	1,465,040
206	Rehabilitimi, Operimi dhe Transferimi i Hidrocentralit "Labinot-Mal"	12,500
207	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Fterre dhe Fterre 1.	650,566
208	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Tervol	325,800
209	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Faqekuq 1 dhe 2	587,975
210	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Dishnicë	15,300
211	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Lubonjë	39,000
212	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Çarshovë	83,500
213	Shërbimi i Hemodializës	1,177,420
214	Shërbimi i markimit dhe monitorimit të karburanteve	444,939
215	Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të konteinerve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë.	2,836,560
216	Krijimi dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të pullave fiskale.	1,263,675
217	Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi i Aeroportit "Nënë Tereza"	9,114,560
218	Ndërtimi, shfrytëzimi i portit të jahteve në qytetit e Durrësit. (BOT)	1,356,145
219	Ndërtimi i portit të jahteve në Kalanë e Turrës, Komuna Synej, Kavajë.	4,450,000
220	Menaxhimi, operimi, mirembajtja dhe përmiresimi teknik i terminalit të konteinerve në portin e Durrësit	3,191,825

221	Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale.	1,503,283
222	Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumentëve matës, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm.	70,000